




Регионална платформа на западен Балкан за застапување  
на слободата на медиумите и за заштита на новинарите  
Western Balkan's Regional Platform for Advocating  
Media Freedom and Journalists' Safety

# **MAQEDONIA E VERIUT**

## **Indikatorë për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve 2019**





**MAQEDONIA  
E VERIUT  
Indikatorë për  
nivelin e lirisë  
së mediave dhe  
sigurinë e  
gazetarëve  
2019**

**Autorë:  
Dragan Sekulovski,  
Deniz Sulejman**

## Titulli

Maqedonia e Veriut - Indikatorë për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve 2019

## Botues

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM)



ЗДРУЖЕНИЕ  
НА НОВИНАРИТЕ  
НА МАКЕДОНИЈА

## Autorë

Dragan Sekullovski  
Deniz Sulejman

## Lektor

Kristina Naceva

## Design

comma | communications design

Ky botim është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe Fondit Evropian për Demokraci. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë dhe nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian ose të Fondit Evropian për Demokraci.



<b>QËLLIMET E PROJEKTIT</b>	<b>4</b>	<b>C Siguria e gazetarëve</b>	<b>21</b>
<b>SHËNIME METODOLOGJIKE</b>	<b>5</b>	C1 Statistika për sulmet ndaj gazetarëve dhe mosndëshkimi	21
<b>Hyrje</b>	<b>7</b>	C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe e aktorëve politikë ndaj sigurisë së gazetarëve	25
<b>A Mbrojtja juridike</b>	<b>9</b>	C3 Efikasiteti i sistemit gjyqësor në mbrojtjen e gazetarëve	26
A1 Garancitë juridike për lirinë e mediave dhe zbatimimi i tyre në praktikë	9	<b>Analiza dhe konkluzione</b>	<b>27</b>
A2 Mbrojtja e pluralizmit politik në media	11	Rekomandime	29
A3 Mbrojtja e pluralizmit politik në media	12	A Ndërhyrjet ligjore dhe përmirësimi i implementimit të ligjeve:	29
A4 Liria e punës dhe shoqërimit të gazetarëve	13	B Përmirësimi i të drejtave të punës së gazetarëve:	29
A5 Mbrojtja e burimeve të informacioneve	14	C Përforcimi i sigurisë së gazetarëve:	29
A6 E drejta për qasje në informata	14		
<b>B Pozita e gazetarëve në redaksi</b>	<b>16</b>		
B1 Kufizimet ekonomike në punën e gazetarisë	16		
B2 Pavarësia e gazetarëve nga pronarët e mediave dhe menaxherët	17		
B3 Pavarësia e gazetarëve në difuzerin publik	17		
B4 Pavarësia e gazetarëve në sektorin jofitimprurës	18		
B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	19		
B6 Pozita e femrave në gazetari	19		

# QËLLIMET E PROJEKTIT

Shoqatat e gazetarëve nga pesë vende të Ballkanit Perëndimor (të Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Kosovës dhe Serbisë), me mbështetjen e Komisionit Evropian<sup>1</sup>, në vitin 2016 i bashkuan përpjekjet për të monitoruar dhe përmirësuar nivelin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve në vendet e tyre – duke e krijuar Platformën Rajonale të Ballkanit Perëndimor për Përfaqësimin e Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve. Bazuar në metodologjinë e përbashkët për hulumtim, zhvilluar enkas për këtë qëllim, çdo vit këto organizata grumbullojnë të dhëna, i vlerësojnë zhvillimet e reja dhe zbatojnë aktivitete për përfaqësim, për të ndryshuar mjedisin politik, ligjor dhe institucional në të cilin veprojnë gazetarët dhe mediat.

Rezultatet e arritura në ciklin e parë trevjeçar treguan se shoqatat e gazetarëve në rajon mund të luajnë rol vendimtar në nxitjen për liri më të madhe të mediave. Rezultatet e arritura janë njohur nga Komisioni Evropian, si një hap kryesor drejt demokratizimit të plotë të shoqërive ballkanike, që ka rezultuar në vendimin e të njëjtit për të vazhduar mbështetjen e Platformës Rajonale në vitet e ardhshme<sup>2</sup>. Ky Raport narrativ u përpilua në kuadër të Vlerësimit të katërt rajonal të nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor, i zbatuar në vitin 2019<sup>3</sup>.

- 
- 1 Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Përfaqësimin e Lirive të Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve është projekt i financuar nga Komisioni Evropian, në kuadër të Programit për Shoqëri Civile dhe Media 2014/15, Mbështetje e rrjeteve tematike të organizatave civile.
  - 2 Komisioni Evropian e miratoi projektin e ri trevjeçar „Safejournalists.net“ me marrëveshje për grant IPA /2019/414-122
  - 3 Vlerësimi i nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor në vitin 2019 u financua nga European Endowment for Democracy.

# SHËNIME METODOLOGJIKE

Metodologjia<sup>4</sup> e hulumtimit përbëhet nga tre grupe indikatorësh, të strukturuar në bazë të një analize sistematike të drejtimeve të ndryshme, të përpiluara nga disa organizata relevante ndërkombëtare<sup>5</sup>. Gjatë katër viteve të fundit indikatorët e zhvilluar fillestarë janë testuar dhe rafinuar për t'u përshtatur me kontekstin karakteristik socio-politik në këtë rajon dhe për të pasqyruar nevojat dhe interesat specifike të gazetarëve në pesë vendet.

Për t'iu përgjigjur pyetjeve indikative, në lidhje me secilin indikator specifik, janë përdorur një sërë metodash të ndryshme të hulumtimit për grumbullimin dhe analizën e të dhënave:

- Analiza të studimeve, analiza, raporte nga hulumtimet, dokumente për politika, strategji dhe dokumente të tjera;
- Analiza cilësore për dokumentet juridike;
- Grumbullimi dhe analiza e informacioneve të publikuara në ueb faqet e institucioneve publike dhe organizatave dhe organeve tjera;
- Grumbullimi dhe analiza e kumesave të mediave, teksteve dhe informacioneve të tjera të publikuara nga organizatat profesionale;
- Të dhëna të grumbulluara nga shoqatat e gazetarëve;
- Intervista të thella me ekspertë, gazetarë dhe krijues të politikave (gjithsej 10 për nevojat e këtij raporti);
- Grupe të fokusit me gazetarë (dy fokus grupe të zhvilluara për nevojat e këtij raporti);
- Të dhëna zyrtare statistikore të marra nga institucionet publike dhe komunat<sup>6</sup>, që janë në dispozicion në ueb faqet ose nga burime të tjera të publikuara.

At national level, journalist associations nominated national researchers to conduct data collection and write narrative reports, which were then reviewed by two reviewers and the lead researcher.

The three sets of indicators used to assess the level of media freedom and journalists' safety in the Western Balkans are presented in the table below.

---

4 Edicioni i katërt i përshtatur i metodologjisë së hulumtimit është përgatitur nga Snezhana Tërpevska, hulumtuuese kryesore dhe Igor Micevski, bashkëpunëtor-hulumtues, nga Instituti për Hulumtimin e Zhvillimit Shoqëror RESIS nga Shkupi, Republika e Maqedonisë së Veriut.

5 Gjatë zhvillimit të qasjes specifike hulumtuuese për vendet e Ballkanit Perëndimor u morën në konsideratë këto dokumente: Këshilli i Evropës: Indikatorët për mediat në demokraci; UNESCO: Indikatorët për zhvillimin e mediave (MDI) dhe Indikatorët për sigurinë e gazetarëve: Niveli kombëtar; USAID - IREX: Indeksi i qëndrueshmërisë së mediave; Freedom House: Anketa për lirinë e shtypit; Servisi Botëror i BBC: Iniciativa për zhvillimin e mediave afrikane; Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve: Dhuna ndaj gazetarëve; Reporterët pa Kufij: Indeksi i Lirisë së shtypit në botë.

6 Gjatë korrikut të vitit 2019 u janë dërguar mbi 90 shkresa zyrtare institucioneve të ndryshme në bazë të Ligjit për qasje në informata me karakter publik.

Tabela e indikatorëve:

A. Mbrojtja juridike	B. Pozita e gazetarëve në redaksitë	C. Siguria e gazetarëve
A.1 Garancitë juridike për lirinë e mediave dhe zbatimimi i tyre në praktikë	B.1 Kufizimet ekonomike për punën e gazetarëve	C.1 Statistika e sulmeve ndaj gazetarëve dhe mosndëshkimi
A.2 Efekti i ligjeve për shpifje ndaj gazetarëve	B.2 Pavarësia nga pronarët e mediave dhe menaxherët	C.2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe e politikanëve në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve
A.3 Mbrojtja e pluralizmit politik në media	B.3 Pavarësia e gazetarëve në radiodifuzerin publik	C.3 Efikasiteti i sistemit gjyqësor lidhur me mbrojtjen e gazetarëve
A.4 Liria e punës dhe shoqërimit të gazetarëve	B.4 Pavarësia e gazetarëve në sektorin jofitimprurës	
A.5 Mbrojtja e burimeve të gazetarëve	B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	
A.6 E drejta e qasjes në informacione	B.6 Pozita e femrave në gazetari	



Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet unitar, i themeluar pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, me Kushtetutën e vitit 1991. Kushtetuta është akti më i lartë juridik që e përcakton RMV-në si shtet me demokraci parlamentare me pushtet legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Liria, barazia, sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut të të gjithë qytetarëve janë vlerat më të larta në rendin kushtetues të vendit. Si rregull, pas çdo cikli të zgjedhjeve parlamentare, qeveria formohet nga partitë politike nga blloku maqedonas dhe ai shqiptar, të cilët kanë fituar më shumë vota në zgjedhje. Nuk ka të dhëna të sakta për numrin e përgjithshëm të popullsisë në vend, sepse regjistrimi i fundit është bërë në vitin 2002, kur popullsia e përgjithshme ishte 2.022.547 banorë, me përkatësi etnike të ndryshme: maqedonas 65.17%, shqiptarë 25.17%, turq 3.85%, romë 2.66%, serbë 1.78% dhe përqindje më e ulët e bashkësive tjera etnike (boshnjakë, vllleh, bullgarë, malazezë etj.). Vendi është tronditur për vite me radhë nga skandale të nivelit të lartë të korrupsionit, që thellësisht është e rrënjosur në të gjitha poret e shoqërisë së tij.

Në vitin 2019 në shtet u rrit paga minimale, por edhe ajo mesatare. Me këtë, gjithashtu, u vërejt një rritje e konsiderueshme e pagës mesatare të gazetarëve dhe të punonjësve mediatik. Sidoqoftë, paga mesatare e gazetarëve është akoma më e ulët se mesatarja shtetërore. E, për më tepër, brengos fakti që pagat e gazetarëve nga qytete më të vogla në vend janë dukshëm më të ulëta në krahasim me kolegët e tyre që punojnë në kryeqytin. Në vitin 2019, një sasi e madhe e fondeve publike u derdhën në media: përmes fushatave partiake për zgjedhjet presidenciale të vitit 2019; blerjes së hapësirës mediatike nga partitë jashtë fushatës zgjedhore dhe përmes formave të ndryshme të financimit të mediave private nga buxhetet e pushtetit vendor. E gjithë kjo e minoi seriozitetin politikën redaktuese të mediave dhe ndikoi në nivelin

e vetë-censurimit të gazetarëve. Gazetarët dhe punonjësit e mediave mbeten ekonomikisht të pasigurt dhe, pothuajse, nuk ka marrëveshje kolektive me të cilat mbrohen të drejtat e tyre të punës. Numri i përgjithshëm i gazetarëve profesionistë është i panjohur por, sipas vlerësimit të SHGM-së, janë rreth 1.000 gazetarë që punojnë në të gjitha llojet e mediave në vend, përfshirë edhe servis publik.

Mediat vështirë mbijetojnë në tregun modest, por të stërbushur mediatik. Analizat e organit rregullator thonë se buxhetet po zvogëlohen, ndërsa dhjetëra radiodifuzerë gjatë vitit të kaluar kanë ndaluar me punë. Në

dhjetor të vitit 2019 kishte 120 radiodifuzerë në sektorin audiovizual, 48 prej të cilëve ishin TV dhe 72 radio-stacione. Gjithsej 11 subjekte emetojnë programe televizive në nivel nacional (5 tokësorë, 4 kabllovikë dhe 2 televizione satelitore), 18 subjekte në nivel rajonal dhe 19 në nivel lokal. Nga radiostacionet, vetëm 4 transmetojnë në nivel nacional, ndërsa 17 në nivel rajonal dhe mbi 50 radiostacione në nivel lokal. Në vitin 2019 pushoi së funksionuari edhe gazeta ditore "Nezavisen" dhe kështu mbetën gjithsej 5 gazeta ditore në treg (3 në gjuhën maqedonase dhe 2 në gjuhën shqipe), kurse në sferën online punojnë qindra media të njohura, që janë pjesë e Regjistrimit Profesional të Mediave Online.

## A1 Garancitë juridike për lirinë e mediave dhe zbatimi i tyre në praktikë

Garancitë themelore të lirisë së shprehjes dhe pavarësisë së mediave janë inkorporuar në Kushtetutë, në ligjet mediatike<sup>1</sup> dhe në disa ligje të tjera<sup>2</sup>. Të gjitha këto ligje, gjithashtu, mbulojnë të drejtën e qasjes në internet, respektivisht nuk ekziston ndonjë rregullore e veçantë që rregullon vetëm Internetin. Në krahasim me vitin e kaluar, përgjithësisht nuk ka dallime të konsiderueshme në shkallën e lirisë së mediave, por ka një rritje të vogël të presioneve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Edhe këtë vit, gjendja e dobët financiare e mediave dhe statusi i pasigurt socio-ekonomik i gazetarëve kanë një ndikim negativ në gjendjen e gazetarisë dhe në cilësinë e përmbajtjeve gazetareske. Sipas “Reporterëve pa Kufij”, RMV-ja në vitin 2019 ishte 14

1 Ligji për media, “Gazeta Zyrtare e RM” nr. 184/2013 dhe nr. 13/2014 dhe Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, “Gazeta Zyrtare e RM” nr. 184/2013; 13/2014; 44/2014; 101/2014; 132/2014; 13/2016; 142/2016; 132/2017; 168/2018; 248/2018; 27/2019; 154/2019.

2 Ligje të tjera të rëndësishme për mediat dhe gazetaret janë Kodi Penal, që e sanksionon nxitjen e urrejtjes dhe përhapjen e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit kompjuterik, Kodi Zgjedhor, që i përcakton rregullat për raportim të mediave gjatë fushatës parazgjedhore, Ligji për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje, Ligji për të drejtën autoriale dhe Ligji për qasje të lirë në informata të karakterit publik.

vende më lartë në indeksin botëror, kështu që tani renditet në vendin e 95-të nga gati 180 shtete<sup>3</sup>.

Në dhjetor të vitit 2018 Kuvendi i votoi ndryshimet dhe plotësimin e Ligjit për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale (LSHMAA), ku janë inkorporuar numri më i madh i vërejtjeve dhe rekomandimeve të SHGM-së dhe organizatave të tjera mediatike, të paraqitura në disa debate përmes procesit të konsultimit publik. Në gjysmën e parë të vitit 2019, SHGM-ja u përfshi në grupe pune për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të tjera relevante për sektorin mediatik<sup>4</sup>. Sidoqoftë, vërejtje thelbësore e SHGM-së është se procesi i ndryshimit të këtyre ligjeve është i ngadalhtë, kurse disa nga këto iniciativa janë vetëm paralajmërime, pa hapa specifikë të zbatimit<sup>5</sup>.

Gjatë vitit 2019 kishte përpjekje nga shteti për të vendosur licenca për mediat e shkruara ose për ato online. SHGM-ja dhe Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni (KEMM) realizuan iniciativë për regjistrimin e mediave profesionale online, me qëllim që të ngritet niveli i profesionalizmit dhe standardeve në gazetarinë online, sepse në të kaluarën kishte përpjekje të shtetit “për të vendosur rend” në këtë sferë<sup>6</sup>.

Gjatë vitit 2019 nuk ka pasur asnjë përpjekje të regjistruar nga Qeveria ose ndonjë organ tjetër shtetëror për të censuruar dhe filtruar përmbajtje të internetit, respektivisht vlerësimi është se e drejta për lirinë e shprehjes në hapësirën e internetit shfrytëzohet lirshëm nga qytetarët, organizatat mediatike ose organizatat e tjera.

Gjatë viteve të kaluara një nga çështjet më me prioritet në debatin për reforma mediatike ishte nevoja të sigurohet pavarësi e trupit rregullator – Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Një numër i ndryshimeve në Ligjin për shërbime mediatike audio

dhe audiovizuale (LSHMAA), që u miratuan në dhjetor të vitit 2018, kishin për qëllim përfundimin e pavarësisë së këtij organi rregullator. Por, Kuvendi ende nuk e ka kryer zgjedhjen e përbërjes së re të Këshillit të Agjencisë për shkak të mospajtimeve partiake në kuadër të Komisionit për zgjedhje dhe emërimet të Kuvendit të RMV-së. Gjatë vitit, Agjencia ka dërguar shkresa në SHGM në të cilat thuhet se mjetet e parapara ligjore për punën e Rregullatorit nuk kanë mbërritur dhe nuk janë paguar në kohë nga institucionet kompetente. Në lidhje me punën e Agjencisë në opinion janë dhënë disa vërejtje (që trashëgohen vite me radhë) lidhur me azhurnimin dhe pavarësinë e këtij organi<sup>7</sup>, edhe pse për vitin 2019 nuk mund të jepen vërejtje më serioze për punën e të njëjtit.

Edhe përpos vendimit të Qeverisë së RMV-së për t'u ndërprerë shpalljet shtetërore në mediat private, sipas hulumtimit të SHGM-së, që është bërë për nevojat e këtij raporti, ky vendim nuk respektohet nga autoritetet lokale. Mënyra se si shpenzohen buxhetet e komunave ose të ndërmarrjeve publike në nivel lokal në mediat private e sjell në pikëpyetje politikën e tyre të pavarur redaktuese dhe ekziston rreziku që me këtë të ndikohet negativisht në përmbajtjet gazetareske.

**Në shkresën e SHGM-së drejtuar komunave dhe ndërmarrjeve publike komunale, me të cilën kërkohet të përgjigjen se sa mjete kanë planifikuar të shpenzojnë për qëllime të ndryshme në media ose për gazetarët në vitin 2019, prej 80 komunave janë përgjigjur vetëm 43 prej tyre. Shuma e përgjithshme që këto 43 komuna kanë parashikuar shpenzime për këtë çështje arrin 25.766.153 denarë. Nga ana tjetër, prej shtatë ndërmarrjeve publike, janë përgjigjur vetëm dy prej tyre: NPK “Kumanova” – se nuk kanë planifikuar mjete për këtë qëllim dhe NPK “Komunalec” nga Prilepi se ka planifikuar shumë prej 130.000 denarëve. Të dhënat e analizës konfirmojnë se autoritetet lokale nuk e respektojnë vendimin e Qeverisë për të mos financiar mediat private.**

3 Reporterët pa Kufij, Raport i Reporterëve pa Kufij për vitin 2019, pjesa Maqedonia e Veriut. Qasur më 15 mars të vitit 2020: <https://rsf.org/en/republic-north-macedonia>

4 Grupi i parë i punës është formuar për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje, kurse grupi i dytë i punës për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor në pjesën e fushatave parazgjedhore mediatike. Ende nuk është përcaktuar afati kur do të hynë në fuqi ndryshimet dhe plotësimet. Përpos kësaj, SHGM-ja dhe Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatikë (SHGPPM) në Ministrinë e Drejtësisë kanë iniciuar ndryshime dhe plotësime të Kodit Penal me qëllim që gazetaret dhe punonjësit mediatikë, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tyre, të kenë statusin e personave zyrtarë për shkak të sigurisë së gazetarëve më të madhe në të ardhmen. Këtë iniciativë, për shkak të krizës politike, Ministria e Drejtësisë e ka shtyrë për vitin 2020.

5 Për shembull, edhe pse Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje parashikohej që në “Planin 18” të vitit 2018, Grupi i punës i formuar nga Ministria e Drejtësisë në qershor të vitit 2019 ende nuk ka filluar me punë.

6 Regjistri i mediave profesionale online, që u promovua në dhjetor të vitit 2019, si rezultat i kësaj iniciative, është në dispozicion në ueb platformën [www.promedia.mk](http://www.promedia.mk).

7 Në Raportin e Katërt Periodik të Monitorimit për Punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA) dhe Agjencisë për Komunikime Elektronike (AKE) disa organizata joqeveritare konstatojnë se në periudhën maj-gusht 2019, SHMAA shpesh ka reaguar: “...për presione dhe sulme verbale ndaj gazetarëve dhe mediave nga politikanë, përfaqësues të pushtetit dhe institucione shtetërore, që nuk ka qenë praktikë konstante në periudha, në të kaluarën, kur numri i sulmeve politike dhe presionet ndaj gazetarëve dhe mediave ishte shumë më i madh dhe më i shpeshtë”, faqe 15. Qasur më 15 dhjetor të vitit 2019: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/11/chetvrti-periodichen-izveshtaj-za-rabotata-na-avmu-i-ae-k-maj-%E2%80%93-93-avgust-2019.pdf>

Në vitin 2018, Qeveria miratoi vendim<sup>8</sup> me të cilin për mediat e shkruara nga Buxheti janë ndarë 50 milionë denarë për mbulimin e shpenzimeve për shtyp dhe distribuim për vitin 2017, edhe atë në lartësi deri në 50% për mediat e shkruara në gjuhën maqedonase dhe prej 50% deri 70% për botimet e shtypura në gjuhët e bashkësive etnike. Kjo praktikë e subvencionimit shtetëror për një numër të mediave vazhdoi edhe në vitin 2019 dhe shumat ishin të ngjashme sikurse në vitin paraprak. Ky proces, përgjithësisht, mund të vlerësohet si transparent, sepse në Komisionin që vendoste për mjetet kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të organizatave mediatike, ndër të cilët edhe nga SHGM-ja. Por, mungojnë analiza rreth asaj se sa këto mjete kontribuojnë në përmirësimin e pozitës socio-ekonomike të gazetarëve, nëse këto mjete investohen në zgjerimin e rrjetit të korrespondentëve të gazetave nacionale dhe në përmirësimin e cilësisë së përmbajtjeve<sup>9</sup>.

Përpos radiove dhe TV-programeve në gjuhët e bashkësive etnike në kuadër të servisit publik radiodifuziv, nuk ekzistojnë mekanizma të tjerë për financimin e mediave në gjuhët e bashkësive të ndryshme etnike. Mediat që publikojnë përmbajtje në gjuhët e bashkësive më të vogla etnike në RMV nuk janë atraktive për shpallësit, kështu që ato me vite ballafaqohen me vështirësi financiare për të qëndruar në treg. Mungon politikë adekuatë mediatike për zgjidhjen e këtij problemi, gjë që reflektohet në pasqyrën e përgjithshme pluraliste në media në RMV.

Në përputhje me Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, për punën e RTVM-së ndahen 0.8% nga buxheti vjetor i RMV-së por, gjatë vitit 2019 ky servis publik, megjithatë, ballafaqohet me vështirësi financiare, sepse nuk i merrte të gjitha mjetet e nevojshme. Në Raportin e “Reporterëve pa Kufij” për vitin 2019 thuhet se RTVM-ja u shërben interesave të opozitës. Megjithatë, mënyra se si raportonte RTVM-ja për zgjedhjet presidenciale, të mbajtura në maj të vitit 2019, u vlerësua si e kënaqshme, që është indikator se servis publik prirret të raportojë objektivisht për tema me interes publik.

Sipas analizës së ASHMAA-së, buxheti i RTVM-së në vitin 2018 ishte 15.485.000 euro<sup>10</sup>, kurse në vitin 2019 pritet të jetë në të njëjtin nivel, që është problem sepse kjo shumë është në nivelin e 0.6% të Buxhetit dhe RTVM-së do t'i mungojnë 6 milionë për vitin 2019. Përkundër përmirësimit të bazës ligjore për financimin e RTVM-së, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA) nuk e respekton detyrimin për të siguruar minimumin ligjor për financimin e RTVM-së dhe kështu të njëjtës i shkaktohen vështirësi shtesë financiare dhe borxhe ndaj shtetit<sup>11</sup>.

## A2 Mbrojtja e pluralizmit politik në media

Shpifja dhe ofendimi u dekriminalizuan në vitin 2012, me miratimin e Ligjit për përgjegjësinë civile për ofendim dhe shpifje. Asnjë ndryshim nuk është bërë në ligj deri në fund të vitit 2019, megjithëse ishte parashikuar në “Planin 18” të Qeverisë, në mënyrë që ndryshimet të korrespondojnë me trendet e reja evropiane. Është ngritur një grup pune në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, në të cilin grup merr pjesë edhe një përfaqësues i SHGM-së, por asnjë mbledhje nuk u është mbajtur në vitin 2019.

Sipas informatave të dorëzuara në SHGM, deri në fundit të korrikut të vitit 2019, në Gjykatën Themelore Civile Shkup ka pasur 25 lëndë aktive për shpifje ose ofendim, në të cilat si palë paraqitet një gazetar apo media. Nga ana tjetër, sipas statistikës së SHGM-së, lista e 25 lëndëve deri në fund të vitit 2019 është rritur për së paku pesë raste, kështu që numri i lëndëve aktive është rreth 30 sosh. Për dallim nga viti i kaluar, në vitin 2019 kemi më shumë raste kur funksionarë të lartë partiakë dhe shtetërorë kërcënuan publikisht se do të padisin gazetarë për shpifje dhe ofendim<sup>12</sup>.

Deri në maj të vitit 2018 praktika e Gjykatës në Shkup dhe e gjykatave të tjera në RMV nuk ishte e sinkronizuar, sa i përket çështjes së shpifjes dhe ofendimit në mediat online. Në vitin 2018 SHGM-ja parashtroi iniciativë me shkrim në Gjykatën Supreme të RMV-së,

8 Qeveria e RMV, “Programi për mbështetjen e mediave të shkruara për shtyp dhe distribuim për vitin 2018”. Qasur më 18 tetor të vitit 2019: [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/programa\\_za\\_finansiska\\_poddrshka\\_za\\_pechatenje\\_i\\_distribucija\\_na\\_pechatenite\\_mediumi\\_za\\_2018\\_godina.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/programa_za_finansiska_poddrshka_za_pechatenje_i_distribucija_na_pechatenite_mediumi_za_2018_godina.pdf).

9 Në nëntor të vitit 2019, njëra ndër gazetat ditore në gjuhën maqedonase “Nezavisen” ndaloi botimin për shkak të vështirësive financiare. Kjo gazetë nuk ishte pjesë e mediave të subvencionuara për shkak të mosplotësimit të një pjese të kriterëve.

10 Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale, “Analiza e tregut të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale për vitin 2018”. Qasur më 19 tetor të vitit 2019: <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2019/07/Analiza-na-pazarot-na-audio-i-audiovizuelni-mediumski-uslugi-za-2018-godina.docx.pdf>.

11 Deri në fund të qershorit të vitit 2019, sipas të dhënave nga DAP-i, borxhet e RTVM-së, mbi bazën e tatimit mbi fitimin arrijnë 473.000 euro.

12 Pellagjia Stojançova, “Rrodhën dokumente për ‘Zhvajtjen’, Zaev, Dimitrov dhe Shekerinska paralajmërojnë padi”, Radio Evropa e Lirë, 24 gusht 2019. Qasur më datën 17 tetor 2019: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/30126949.html>.

me kërkesë që të harmonizojë praktikën gjyqësore, kurse në maj të vitit 2019 katër Gjykatat e Apelit miratuan konkluzion se mediat online, që paraqiten si palë para gjykatave civile, në procedurat për shpifje dhe ofendim do të trajtohen njëjtë sikurse mediat tradicionale.

Sipas avokatëve me të cilët bashkëpunon SHGM-ja, që i përfaqësojnë gazetarët në lëndët gjyqësore për veprat shpifje dhe ofendim, gjykatësit në përgjithësi i marrin parasysh vendimet e Këshillit për Etikë në Media (organ mediatik vetërregullues) gjatë mënyrës së udhëheqjes së procedurës gjyqësore. Përpos kësaj, në arsyetimin e aktgjyqimeve, në të cilat së paku njëri nga palët është gazetar, shpesh citohen rasetet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që paraqet progres në krahasim me të kaluarën.

Gazetarët që ishin pjesë e grupeve të fokusit<sup>13</sup>, të zhvilluara për nevojat e kësaj analize, konsiderojnë se paditë për shpifje dhe ofendim më shumë janë shfrytëzuar si instrument për presion ndaj tyre në të kaluarën, mbase brengos fakti që gjatë vitit 2019 funksionarë të lartë qeveritarë disa herë janë kërcënuar publikisht me padi për shpifje ndaj gazetarëve.

**Kah fundi i vitit 2019, kryeministri i RMV-së, Zoran Zaev, e shfrytëzoi të drejtën e padisë civile për shpifje ndaj gazetarit Zoran Bozinovski, për një postim të publikuar në profilin e gazetarit në Facebook, në të cilin ai shkroi për përfshirjen e supozuar të kryeministrit në korrupsion. Këtu e rëndësishme të theksohet se, sipas rekomandimeve të Këshillit të Evropës, politikanët, veçanërisht ata me pozitë të lartë, duhet të kenë një prag më të lartë të tolerancës për kritikën gazetareske.**

### A3 Mbrojtja e pluralizmit politik në media

Në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nuk ka dispozita konkrete që përmbajnë obligime eksplicite të radiodifuzerëve për sigurimin e balancimit politik jashtë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore. Megjithatë, parimet për ushtrimin e vep-

rimtarisë përmbajnë një dispozitë<sup>14</sup> e cila u referohet të gjithë radiodifuzerëve dhe të cilën Rregullatori e shfrytëzon si bazë për monitorim të raportimit të tyre që nga shpallja e zgjedhjeve e deri në fushatën zgjedhore, kur zbatohen dispozitat e parashikuara me Kodin Zgjedhor. Obligimet e RTVM-së lidhur me këtë çështje, përpos me këtë nen, janë paraparë edhe në nenin 110<sup>15</sup>.

Megjithëse nuk ka detyrim të qartë për Rregullatorin për të monitoruar pluralizmin politik edhe jashtë fushatës zgjedhore, megjithatë në kompetencat e përgjithshme të Rregullatorit është nënvizuar se “kujdeset për mbrojtjen dhe zhvillimin e pluralizmit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale ...”, që e nënkupton gjithashtu pluralizmin politik në çdo kohë. Vitet e fundit, Rregullatori ka realizuar analiza të pluralizmit politik jashtë periudhës zgjedhore dhe, gjithashtu, ka miratuar një Doracak të veçantë<sup>16</sup>.

Gjatë vitit 2019 as Rregullatori e as ndonjë organizatë tjetër nuk ka zbatuar analizë të pluralizmit politik në lajme, kështu që është vështirë të përgjigjet në mënyrë më precize nëse partitë politike kanë qasje korrekte ndaj mediave audiovizuale jashtë zgjedhjeve. Por, vlerësim i përgjithshëm i ekspertëve të mediave, të intervistuar për nevojat e kësaj analize, është se “...sot gjendja është shumë më e mirë në krahasim me periudhën deri në vitin 2019, kur mediat më me ndikim vazhdimisht raportonin nën ndikimin e partisë në pushtet”<sup>17</sup>.

Pluralizmi politik gjatë fushatës zgjedhore rregullohet nga Kodi Zgjedhor, si për servis publik ashtu edhe për mediat private, kurse organi rregullator është i autorizuar të monitorojë raportimin e mediave radiodifuzive (transmetuese). Për zgjedhjet presidenciale të vitit 2019, ASHMAA-ja zhvilloi monitorim dhe inicioi gjithsej katër procedura kundërvajtëse kundër radiodifuzerëve, që është dukshëm më pak në kra-

13 Për nevojat e këtij hulumtimi u zhvilluan dy grupe të fokusit me gjithsej 19 gazetarë, grupi i parë i fokusit më 28 nëntor të vitit 2019 me gazetarë nga 7 media, ndërsa i dyti më 29 nëntor të vitit 2019, po ashtu, me gazetarë nga shtatë media.

14 Neni 61 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale e rregullon parimin për “paraqitjen e ngjarjeve në mënyrë objektive dhe të paanshme me trajtim të njëjtë të pikëpamjeve dhe mendimeve të ndryshme dhe mundësimin e formimit të lirë të mendimit të publikut për ngjarje dhe çështje të caktuara”

15 Në nenin 110, ndër të tjera, përcaktohet obligimi i servisit publik: “të sigurojë informim të vazhdueshëm, të vërtetë, të plotë, të pa anshëm, të drejtë dhe në kohë duke krijuar dhe transmetuar programe me cilësi të lartë për të gjitha ngjarjet me rëndësi politike, ekonomike, sociale, shëndetësore, kulturore, arsimore, shkencore, fetare, ekologjike, sportive dhe ngjarje tjera...”

16 Doracak për vlerësimin e pluralizmit mediatik i AVMAA, i miratuar në vitin 2012, në dispozicion në: [https://ovmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Priracnik\\_1\\_Pluralizam\\_finalna.pdf](https://ovmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Priracnik_1_Pluralizam_finalna.pdf)

17 Intervistë me Dr. Snezhana Terpevska, eksperte mediatike e Institutit për Hulumtimin e Zhvillimit Shoqëror RESIS, e zhvilluar më 21 dhjetor 2019.

hasim me zgjedhjet e kaluara<sup>18</sup>. Në të njëjtën kohë, Agjencia në raportet e saj nuk konstatoi disbalancë të madhe në raportimin e mediave për parti politike dhe kandidatë të caktuar.

#### A4 Liria e punës dhe shoqërimin të gazetarëve

Në RMV profesioni i gazetarisë nuk i nënshtrohet licencimit, por problem është që në Ligjin për mediat ekziston definicioni për nocionin gazetar<sup>19</sup>, që nga SHGM-ja dhe organizatat e tjera mediatike vlerësohet si bazë për kufizimin e ushtrimit të lirë të profesionit të gazetarisë. Përcaktimi i asaj se çfarë është gazetar dhe kush mund të jetë gazetar nuk duhet të jetë subjekt i ligjit, por mund të jetë çështje e vetë-rregullimit.

Për dallim nga viti 2018, kur akreditimi i gazetarëve nuk ishte temë, në vitin 2019 Qeveria hapi diskutim publik mbi nevojën e përcaktimit të kriterëve për lëshimin e akreditimeve për gazetarët për raportim nga ngjarjet publike, në kuadër të Projekt-Planit<sup>20</sup> për aksion vendimtar kundër përhapjes së dezinformatave dhe sulmeve ndaj demokracisë. SHGM-ja e kritikoi këtë Plan me mendimin se disa nga masa janë problematike, duke theksuar se: "Ajo që nuk është theksuar deri në fund, lidhur me këto propozim-masa, mund të interpretohet si një përpjekje për të kufizuar lirinë e shprehjes dhe kështu t'i shkaktohet dëm sektorit edhe ashtu të brishtë mediatic në vendin tonë"<sup>21</sup>.

Në vitin 2019 SHGM-ja ka vërejtur dy raste të pengimit të gazetarëve të raportojnë nga ngjarjet. Në rastin e parë ekipi gazetaresk i RTVM-së ishte penguar të raportojë nga oborri i kishës në lagjen Lisiçe të Shkupit, gjatë festave të pashkëve "për shkak të pranisë së delegacionit të lartë"<sup>22</sup>. Në rastin e dytë punonjësit e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nuk kanë lejuar praninë e gazetarëve të cilët kanë dashtur të ndjekin mbledhjen në të cilën Komisioni disiplinor është dashur të debatojë për punën e njërit nga inspektorët e arsimit<sup>23</sup>. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë e ka dënuar edhe sjelljen e punonjësve në Gjykatën Kushtetuese të cilët në mënyrë të paljesueshme i kanë urdhëruar gazetarët ta lëshojnë ndërtesën e Gjykatës. Ekipet e gazetarëve paraprakisht janë ftuar të ndjekin takimin ndërmjet kryetarit të Gjykatës Kushtetuese Sali Murati dhe ambasadorit të BE-së në Shkup, Samuel Zbogar<sup>24</sup>.

Pjesa më e madhe e gazetarëve janë organizuar në shoqata profesionale. Shoqata më e madhe dhe më e vjetër është SHGM-ja, e themeluar në vitin 1946, anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (FNG) dhe e Federatës Evropiane të Gazetarëve (FEG). Numri i anëtarëve të rregullt të SHGM-së kah mesi i vitit 2018 ishte 680, kurse në tetor të vitit 2019 ky numër është rritur në 860 anëtarë.

Lidhur me mbrojtjen e të drejtave të punës të gazetarëve dhe punonjësve mediaticë, të njëjtit janë të organizuar në kuadër të Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediaticë – SPGM, e cila është e pavarur dhe nuk është pjesë e asnjë organizate sindikaliste në nivel nacional. Ekziston edhe sindikatë e posaçme e servisit radiodifuziv publik e cila nuk është pjesë e SPGM-së. Sipas përfaqësuesve të SGPM-së, forma më e shpeshtë e presionit ndaj gazetarëve-anëtarë të Sindikatës është kur pronarët

18 Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, "Pasqyrë e procedurave kundërvajtëse të ngritura nga ASHMAA për zgjedhjet presidenciale të vitit 2019". Qasur më 21 tetor 2019: <https://avmu.mk/prisedatelnski-zabori-2019/>

19 Në nenin 2, nocioni gazetar definohet si "person i cili grumbullon, analizon, përpunon ose klasifikon informata të publikuara në media dhe është i punësuar në media ose ka kontratë pune me ta apo person që realizon aktivitete gazetareske si profesionist i pavarur (gazetar i lirë)".

20 Qeveria e RMV, "Propozim-plani për aksion vendimtar kundër përhapjes së dezinformatave", (Në nenin 14 të tij thuhet: "Qeveria do të vendosë kriteret të qarta për mediat që janë të akredituara t'i ndjekin ngjarjet qeveritare dhe konferencat e shtypit, në përputhje me standardet e profesionit të gazetarisë"). Qasur më 21 tetor të vitit 2019: [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/predlog-plan\\_za\\_akcija\\_protiv\\_dezinformacii\\_final.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/predlog-plan_za_akcija_protiv_dezinformacii_final.pdf)

21 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "SHGM: Një pjesë e masave në Planin e Qeverisë janë problematike". Qasur më 21 tetor të vitit 2019: <https://znm.org.mk/%D0%B7%D0%BD%D0%BC-%D0%B4%D0%B5%D0%BB-%D0%BE%D0%B4-%D0%BC%D0%B5%D1%80%D0%BA%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B2%D1%80-%D0%BF%D0%BB%D0%B0%D0%BD%D0%BE%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%B2%D0%BB%D0%B0%D0%B4%D0%B0%D1%82%D0%B0?lang=SQ>

22 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "SHGM: E dënojmë pengimin e punës së ekipit të gazetarëve para kishës 'Shën Apostoli Petar dhe Pavle', publikuar në TV NOVA, më 29 prill të vitit 2019. Qasur më 21 tetor të vitit 2019: <https://novatv.mk/znm-osuda-za-poprechuvane-na-rabota-na-novinarska-ekipa-pred-tsirkata-sv-apostoli-petar-i-pavle/>

23 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "SHGM: Dënojmë ngjarjet në MASH", publikuar më 19 korrik të vitit 2019. Qasur më 21 tetor të vitit 2019: <https://znm.org.mk/%D0%B7%D0%BD%D0%BC-%D0%BE%D1%81%D1%83%D0%B4%D0%BO-%D0%B7%D0%BO-%D1%81%D0%BB%D1%83%D1%87%D1%83%D0%B2%D0%B0%D1%9A%D0%B0%D1%82%D0%BO-%D0%B2%D0%BE-%D0%BC%D0%BE%D0%BD?lang=SQ>

24 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "SHGM: Dënojmë trajtimin e gazetarëve në ndërtesën e Gjykatës Kushtetuese", publikuar më 16 dhjetor të vitit 2019. Qasur më 15 shkurt të vitit 2020: <https://znm.org.mk/%D0%B7%D0%BD%D0%BC-%D0%BE%D1%81%D1%83%D0%B4%D0%BO-%D0%B7%D0%BO-%D0%BE%D0%B4%D0%BD%D0%BE%D1%81%D0%BE%D1%82-%D1%81%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%BC%D0%B0-%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%80%D0%B8%D1%82?lang=SQ>

ose menaxherët e mediave shmangin anëtarësinë sindikaliste ta përllogaritin nga paga e gazetarëve, dhe kështu ndodhë që ata të humbin statusin e anëtarëve të Sindikatave. Sipas të dhënave të SPGM-së, gjithsej ka 231 anëtarë të Sindikatave që është më shumë se 20 për qind e numrit të të punësuarve në media.

Këshilli për Etikë në Media (KEMM) është trup vetërregullues i cili ekziston që nga dhjetori i vitit 2013 dhe në të cilin në bazë vullnetare anëtarësohen botuesit e mediave. Kusht për anëtarësim në KEMM është t'u përmbahen parimeve dhe standardeve etike të Kodit të Gazetarëve dhe pranimit të Statutit të KEMM-it. Anëtarët e KEMM-it me këtë obligohen që edhe në mënyrë aktive të përfshihen në procesin e ndërmjetësimit dhe t'i publikojnë vendimet e Komisionit të ankesave pranë këtij organi. Në fund të vitit 2019 u miratuan edhe kriteret për pranimin e portaleve të internetit në Regjistrin e Mediave Profesionale Online, të cilat përfshijnë: transparencën e strukturës së pronësisë, publikimin e impresumit, nënshkrimin e përmbajtjeve të publikuara nga gazetarët/autorët, regjistrimin e detyrueshëm të mediave online si subjekte juridike etj. Krahas KEMM-it, pranë SHGM-së funksionon edhe Këshilli i Nderit, si një mekanizëm i brendshëm vetërregullues, i cili e monitoron respektimin e Kodit të Gazetarëve nga ana e gazetarëve-anëtarë të SHGM-së.

#### A5 Mbrojtja e burimeve të informacioneve

E drejta për mbrojtjen e burimit gazetaresk në RMV është kategori kushtetuese dhe ajo garantohet me Kodin Penal, Ligjin për përgjegjësinë civile për ofendim dhe shpifje, Ligjin për media dhe Ligjin për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale. Në vitin 2019 SHGM-ja konstatoi dy raste në të cilat u rrezikua e drejta mbrojtjes së konfidencës së burimeve nga pushteti ekzekutiv.

Në korrik të vitit 2019, gazetari Lupço Zllatev u thirr në bisedë në MPB, ku i është kërkuar të konfirmojë nëse ai ishte autor i publikimeve në lidhje me dyshimet për veprat e kryera kriminale nga Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë së RMV, si dhe për të zbuluar burimin e informacioneve dhe incizimeve. Ai ka konfirmuar që ishte autori, por ka refuzuar të japë informacione për buri-

min e tij<sup>25</sup>. Për ri-publikimin e të njëjtit lajm, për arsye të njëjta, në mënyrë plotësuese është thirrur në MPB edhe gazetari Goran Momirovski nga TV Alfa. Kjo praktikë mund të ndikojë negativisht në gazetarinë hulumtuese në media, veçanërisht kur publikohen informacione mbi paligjshmërinë në punën e bartësve të funksioneve publike ose për tema të tjera me interes publik.

Në përgjithësi, gjatë punës me tekste hulumtuese, gazetarët ndjehen të lirë në kontaktimin me burimet e informacioneve. Me Ligjin e ri për mbrojtjen e denoncuesve janë rregulluar çështjet e denoncimit të mbrojtur, e drejta e denoncuesve, si dhe veprimi dhe obligimi i institucioneve në lidhje me denoncimin e mbrojtur dhe sigurimin e mbrojtjes së denoncuesve. Me ndryshimet e këtij ligji në vitin 2019 u krye harmonizimi me standardet ndërkombëtare të përshkruara në këtë sferë dhe me të sigurohet mbrojtje më e madhe e denoncuesve. Në këtë drejtim, burimet gazetareske janë inkurajuar që edhe në mënyrë institucionale të mbrohen më mirë. Megjithatë, këtë vit, policia disa herë ka thirrur gazetarë në stacionin policor dhe prej tyre është kërkuar që t'i zbulojnë burimet e tyre të informacioneve. Në të gjitha rastet gazetarët kanë vendosur të mos i zbulojnë burimet e tyre të informacioneve, kurse kjo mund të interpretohet si presion i drejtpërdrejt ndaj gazetarëve për zbulimin e burimeve.

#### A6 E drejta për qasje në informata

Kuvendi i RMV-së në maj të vitit 2019 ka miratuar Ligjin e ri për qasje të lirë te informatat me karakter publik, me të cilin ligj Komisioni transformohet në Agjenci për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë te Informatat me Karakter Publik. Por, ky organ, deri kah mesi i dhjetorit të vitit 2019 ende punonte vetëm me kryetar, sepse procedura për zgjedhjen e anëtarëve të ri ishte bllokuar në Komisionin parlamentar të RMV-së për zgjedhje dhe emërimë. Para fundit të vitit 2019 Kuvendi e zgjodhi drejtorin e këtij organi sipas ligjit dhe, prej dhjetorit të vitit 2019, Agjencia, pas një periudhe të gjatë, përsëri ka kompetenca të vendosë për ankesa të ngritura për shkelje eventuale të kësaj të drejte.

25 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "SHGM e ndjekë nga afër rastin me MPB dhe gazetarin Zllatev", publikuar më 24 korrik të vitit 2019. Qasur më 15 shkurt të vitit 2020: <https://znm.org.mk/%D0%B7%D0%BD%D0%BC-%D0%B1%D1%83%D0%B4%D0%B5%D0%BE-%D0%B3%D0%BE-%D1%81%D0%BB%D0%B5%D0%B4%D0%B8-%D1%81%D0%BB%D1%83%D1%87%D0%B0%D1%98%D0%BE%D1%82-%D1%81%D0%B5-%D0%BC%D0%B2%D1%80-%D0%B8-%D0%BD%D0%BE%D0%B2/?lang=SQ>



Mosfunksionimi i këtij organi në vitin 2019 ndikoi negativisht në sigurimin e qasjes së lirë të informatat me karakter publik, jo vetëm për gazetarët, por edhe për qytetarët, dhe në këtë mënyrë u rrezikua edhe transparenca e institucioneve publike. Në kushtet kur nuk funksiononte organi i shkallës së dytë, qytetarët dhe gazetarët ishin të penguar të marrin informacione, kur institucionet nuk ua siguronin të njëjtat, sepse ata nuk kishin se ku të ankohen, me përjashtim të Gjykatës Administrative ku procedurat për ushtrimin e kësaj të drejte janë shumë të gjata dhe të shtrenjta.

Sipas shumicës së gazetarëve të përfshirë në intervistat e realizuara dhe grupeve të fokusit mund të konkludohet se shumica e institucioneve janë me transparencë “të kufizuar” ose me transparencë deri në nivelin që u përshtatet atyre që drejtojnë institucionin. Sidoqoftë, përgjithësisht, vlerësohet se transparenca në vitin 2019 ishte më e lartë se viteve të kaluara. Qeveria e RMV-së vlerësohet si një institucion shtetëror me transparencë të shtuar në krahasim me institucionet e tjera.

Gjykatat në Shkup, sipas gazetarëve që morën pjesë në fokus-grupe, kanë një transparencë dukshëm më të mirë në krahasim me gjykatat e qyteteve tjera të vendit, ndërsa për Kuvendin sundon mendimi i përgjithshëm se është më transparent, megjithëse shpesh ndodh që të ndodhin vonesa në përgjigjet e kërkuara. Në grupet e fokusit gazetarët kanë paraqitur edhe vlerësimin se transparenca e gjyqësorit është përmirësuar, duke i lejuar ata të mbajnë madje telefona dhe të marrin inserte nga seancat gjyqësore. Nga ana tjetër, “Prokuroria Publike nuk ka praktikë të sigurojë informata të detajuara dhe në kohë”<sup>26</sup>.

Sipas gazetarëve, vetëqeverisja lokale karakterizohet me një nivel më të ulët të transparencës, dhe këtë e dëshmon edhe konstatimi i deklaruar e një numri të pjesëmarrësve në fokus-grupet: “Komuna e Tetovës, për shembull, ka vite që nuk ka publikuar llogari përfundimtare, që është shembull karakteristik për mos-transparencë”<sup>27</sup>.

---

<sup>26</sup> Deklaratë e një gazetari në fokus-grupin e realizuar më 29 nëntor të vitit 2019.

<sup>27</sup> Qëndrim i një gazetari në fokus-grupin e realizuar më 29 nëntor të vitit 2019.

## B1 Kufizimet ekonomike në punën e gazetarisë

Nuk ka të dhëna precize rreth asaj se sa gazetarë kanë kontratë pune, por vlerësim i përgjithshëm është se shumë gazetarë në mediat private kanë, kryesisht, kontrata me kohë të caktuar ose kontrata në vepër. Konsiderohet se shuma e pagës mesatare të gazetarëve është në kuadër të pagës mesatare të shtetit, respektivisht rreth 25.000 denarë neto. Kjo ka të bëjë kryesisht me gazetarët në mediat më të mëdha në kryeqytet, ndërsa në vendet më të vogla të hyrat mujore të gazetarëve janë dukshëm më të ulëta<sup>28</sup>.

Në pyetjen nëse pozicioni i gazetarëve është përmirësuar ose është përkeqësuar, në krahasim me periudhën e kaluar, gazetarët e përfshirë nga grupet e fokusit nuk dhanë përgjigje konkrete. Ndaj mund të konkludohet se nuk ka ndryshime domethënëse.

<sup>28</sup> Nuk ka të dhëna precize rreth asaj se sa gazetarë kanë kontratë pune, por vlerësim i përgjithshëm është se shumë gazetarë në mediat private kanë, kryesisht, kontrata me kohë të caktuar ose kontrata në vepër. Konsiderohet se shuma e pagës mesatare të gazetarëve është në kuadër të pagës mesatare të shtetit, respektivisht rreth 25.000 denarë neto. Kjo ka të bëjë kryesisht me gazetarët në mediat më të mëdha në kryeqytet, ndërsa në vendet më të vogla të hyrat mujore të gazetarëve janë dukshëm më të ulëta.  
Në pyetjen nëse pozicioni i gazetarëve është përmirësuar ose është përkeqësuar, në krahasim me periudhën e kaluar, gazetarët e përfshirë nga grupet e fokusit nuk dhanë përgjigje konkrete. Ndaj mund të konkludohet se nuk ka ndryshime domethënëse. Mbetet fakti që gazetarët punojnë jashtë orari të punës, punojnë pa kompensim gjatë festave dhe në fundjavë dhe kanë liri të kufizuar për të zgjedhur temat në të cilat do të punojnë.

Mbetet fakti që gazetarët punojnë jashtë orarit të punës, punojnë pa kompensim gjatë festave dhe në fundjavë dhe kanë liri të kufizuar për të zgjedhur temat në të cilat do të punojnë.

## B2 Pavarësia e gazetarëve nga pronarët e mediave dhe menaxherët

Nuk ka të dhëna të publikuara që mund të përcaktojnë se sa media private kanë akte ose rregulla organizative të brendshme, sipas të cilave kolegji i redaktues është i ndarë zyrtarisht nga menaxhmenti i mediave. Nga informacionet në dispozicion të SHGM-së dhe nga përgjigjet e marra përmes intervistave me gazetarët, mund të konkludohet se akte të tilla rrallë ekzistojnë. Në mediat më të mëdha, është e zakonshme që redaksitë të ndahen nga strukturat drejtuese, por drejtorët shpesh bëjnë presion ndaj redaksive rreth çështjes se duhet të punojnë në mënyrë që të sigurojnë të ardhura nga sponsorimet ose shpalljet.

Kodi i vetëm që vlen për të gjithë gazetarët profesionistë është Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë, i miratuar në vitin 2001, sipas të cilit veprojnë edhe Këshilli i Nderit i SHGM-së dhe Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni. Nuk ka të dhëna rreth asaj se mediat private kanë kodin e tyre të veçantë të etikës ose rregullave.

Ekzistojnë dëshmi konkrete të presionit të menaxhmentit ndaj gazetarëve, por gazetarët rrallë i denoncojnë ato. Presionet zakonisht nuk shprehen si kërcënime të drejtpërdrejta, por janë subtile dhe më pak të dukshme<sup>29</sup>. Gazetarët edhe më tej vazhdojnë të mos i padisin redaktorët dhe pronarët e mediave, kur shkelen të drejtat e tyre. Për shembull, aktualisht nuk ka asnjë lëndë të hapur gjyqësore kur një gazetar inicion padi për mobing dhe, gjithashtu, nuk ka aktgjykim të formës së prerë për veprën të këtyllë.

Nga ana tjetër, lidhshmëria ndërmjet pronarëve të mediave të caktuara dhe qendrave të fuqisë shpesh është në dëm të gazetarëve që punojnë në këto media. Edhe pse Rregullatori mediatik gjatë viteve të kaluara nuk ka vërejtur lidhshmëri të këtyllë ose koncentrim të fshehur mediatik, megjithatë në opinion shpesh janë publikuar informacione rreth asaj se një numër i mediave nacionale radiodifuzive kanë vetëm pronarë formal, prapa të cilëve qen-

<sup>29</sup> Për këtë, në intervistën e zhvilluar me gazetaren, ajo deklaroi: "Nga përvojat e mëparshme të punës nuk ka kërcënime të drejtpërdrejta, por vetëm sugjerim "qëllimhirë". Intervistën e ka zhvilluar Deniz Sulejman më 25 nëntor të vitit 2019.

drojnë qendrat e fuqisë që ndërlidhen me elitën e biznesit dhe partitë politike.

Në vitin 2019 u vërejtën dy ngjarje që tregojnë mbi presionin e mundshëm nga ana e menaxhmentit ndaj redaktorëve në mediat e shkurta. Kështu që, në maj të vitit 2019 kryeredaktori dhe redaktori përgjegjës i gazetës ditore "Silloboden pečat", Branko Gerovski, sipas prezantimeve të tij publike, është ndërruar nga pozita kryeredaktor nga menaxhmenti dhe pronarët e mediave, për shkak të mospajtimeve lidhur me politikën redaktuese në mediumin në fjalë, për çka ai publikisht ka treguar. Në nëntor të vitit 2019 u shkarkua edhe kryeredaktori i javores "Fokus", Zoran Dimitrovski. Vetë ai ka deklaruar publikisht se dyshon se shkak i mundshëm është "...arsyeja e një sërë tekstesh në të cilat në mënyrë satirike e kritikon garniturën aktuale qeverisëse dhe kryeministrin Zoran Zaev"<sup>30</sup>.

## B3 Pavarësia e gazetarëve në difuzerin publik

RTVM-ja, në vitin 2017, pas paralajmërimeve disavjeçare, e miratoi Kod Etik për gazetarët, kuadrot kreativë dhe të gjithë punonjësit në TVM, që është edhe obligim i saj statutar<sup>31</sup>. Ky Kod, i cili është thuar se tre vjet në fuqi, që nga fillimi hasi në kritika nga komuniteti i gazetarëve për shkak të përmbajtjes së këtij dokumenti, por edhe për shkak të mungesës së transparencës gjatë hartimit të tij. Mangësia më e madhe e këtij Kodi është përzjerja e etikës gazetareske me disiplinën e punës dhe me të drejtat dhe detyrimet e gazetarëve që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës. Komisioni Etik pranë MTV-së, i cili është kompetent për pranimin e ankesave për shkeljet eventuale të Kodit nuk funksionon<sup>32</sup>, kurse kryetari i këtij Komisioni dha dorëheqje në nëntor të vitit 2018. Komisioni deri më tani ka vendosur vetëm për një pezullim dhe një procedurë disiplinore dhe nuk ka asnjë informacion nëse ka pasur raste të tjera që ka trajtuar.

<sup>30</sup> MKD.mk "Zoran Dimitrovski nuk është më redaktor përgjegjës i javores "Fokus", dyshon për presione nga pushteti", publikuar më 22 nëntor të vitit 2019. Qasur më 16 mars të vitit 2020: <https://www.mkd.mk/makedonija/politika/zoran-dimitrovski-vekie-ne-eodgovoren-urednik-na-fokus-se-sommeva-pritisoci-od>

<sup>31</sup> TVM "Kodi Etik i TVM për gazetarët, kuadrot kreativë dhe për të gjithë të punësuarit në TVM", Shkup, viti 2017. Qasur më 29 nëntor të vitit 2019: [http://www.mrt.com.mk/sites/default/files/Этички%20кодекс%20на%20МРТ\\_0.pdf](http://www.mrt.com.mk/sites/default/files/Этички%20кодекс%20на%20МРТ_0.pdf)

<sup>32</sup> Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë "Reformë ose profomë: Funkcionaliteti i Komisionit të Etikës në RTVM", publikuar më 22 nëntor të vitit 2019. Qasur më 5 dhjetor të vitit: <https://znm.org.mk/%D1%80%D0%B5%D1%84%D0%BE%D1%80%D0%BC%D0%B0%D0%B8%D0%B%D0%B8%D0%BF%D1%80%D0%BE%D1%84%D0%BE%D1%80%D0%BC%D0%B0%D1%84%D1%83%D0%BD%D0%BA%D1%86%D0%B8%D0%BE%D0%BD%D0%B0%D0%B%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82/?lang=SQ>

Nga intervistat e realizuara dhe fokus-grupet mund të konkludohet se menaxhmenti, që është i afërt me partinë e tanishme opozitare, ende ka ndikim të madh ndaj redaksive dhe redaktorëve dhe, me këtë, edhe mbi mënyrën si punojnë gazetarët në servis publik<sup>33</sup>. Një nga pjesëmarrësit e fokus-grupeve, i cili më parë ka qenë i punësuar në RTVM, deklaroi: “Në RTVM drejtori vjen nga partia që është në pushtet, ai e emëron kryeredaktorin dhe redaktorin përgjegjës, kurse ky të tjerët. Që do të thotë se ti në çdo moment ke rrezik për censurë dhe televizioni në raste të caktuara i ngjanë shtabit partiak”<sup>34</sup>.

Të gjithë të punësuarve në TVM në tetor të vitit 2019 u janë rritur pagat në mënyrë lineare në lartësi prej 3.500 denarë neto për person dhe, gjithashtu, u nënshkrua marrëveshja e re kolektive – me të cilën garantohej pagesa e regresit për pushim vjetor. Me këtë, në masë të konsiderueshme përmirësohet standardi i gazetarëve, punonjësve mediaticë dhe kuadrit teknik në RTVM. Por, megjithatë, ekziston perceptimi se pagat e gazetarëve, sidomos të atyre që nuk janë fillestarë, janë më të ulëta nga pagat e gazetarëve në televizioneve nacionale private. Megjithatë, për dallim nga mediat private, rregullshmëria e pagesës së pagave të punonjësve në TVM asnjëherë nuk ka qenë problematike e as siguria e vendeve të tyre të punës, që është garantuar me kontratat e nënshkruara për punë.

Ajo që është problematike nga aspekti i pavarësisë së servisit publik është pse menaxhmenti i TVM-së kërkon mendim për punësime të vazhdueshme dhe të përhershme nga Ministria e Financave, në kushte kur neni 104 i Ligjit për shërbime mediaticë audio dhe audiovizuale u garanton status të pavarur redaktorëve, gazetarëve dhe punonjësve të tjerë në organet dhe institucionet shtetërore. Në këtë nën në mënyrë eksplicite thuhet se ata nuk trajtohen si nëpunës publikë.

Kategori e rrezikuar e gazetarëve janë sidomos korrespondentët e RTVM-së, të cilët janë në numër të vogël dhe kanë kryesisht kontrata për angazhim të përkohshëm, të cilat lehtësisht mund të shpëputen. Në nëntor të vitit 2019 u publikua shpallja për angazhimin honorar të dhjetë korrespondentëve, që është progres për RTVM-në, edhe pse SHGM-ja synon model ndryshe me të cilin në mënyrë sistematike dhe të përhershme do të mund të zgjidhet gjendja me këtë kategori të gazetarëve<sup>35</sup>. Me rëndësi thelbësore është që të gjithë gazetarët dhe kameramanët të punësohen me orar të plotë pune, me kontrata në afat të pacaktuar.

## **B4 Pavarësia e gazetarëve në sektorin jofitimprurës**

Në mediat jofitimprurëse bëjnë pjesë radiot që emetojnë më së shpeshti përmbajtje për të rinjtë edhe atë në internet, si dhe mediat online që merren zakonisht me gazetari hulumtuese dhe financohen në mënyrë dominuese ose në tërësi me ndihmë të donatorëve. Si media jofitimprurëse radiodifuzive konsiderohen edhe radiot studentore të cilat aktualisht funksionojnë në kuadër të dy universiteteve shtetërore, Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup dhe Universitetit “Goce Dellçev” në Shtip.

Një numër i mediave informative online jofitimprurëse janë të regjistruara si shoqata civile dhe deri me tani nuk është kryer ndonjë analizë detale për punën e tyre dhe për statusin dhe pavarësinë e gazetarëve në to. Redaksitë e këtyre mediave janë të vogla dhe përfshijnë disa gazetarë që punojnë në bazë ditore, kurse financimi është jostabil dhe i paqëndrueshëm, duke pasur parasysh se këto media varen nga grantet dhe donacionet e huaja. Numri më i madh i këtyre medimeve kanë pranuar ose sillen sipas Kodit Etik, për zbatimin e të cilit kujdeset KEMM.

Presioni ndaj mediave jofitimprurëse, prej të cilave një numër i tyre merren me gazetari hulumtuese, është zvogëluar në krahasim me periudhën deri në vitin 2016, kur gazetarët dhe redaktorët e këtyre mediave shpesh në publik diskreditohehin në bazë personale dhe ndaj tyre përdorej gjuhë e urrejtjes për shkak të teksteve kritike ndaj të fuqishmëve dhe autoriteteve të atëhershme.

**Në vitin 2019 në SHGM u denoncuan dy kërcënime më serioze ndaj gazetarëve të Laboratorit Hulumtues të Reporterëve (LHR). Në rastin e parë është kërcënuar me jetë një gazetar i cili ka hulumtuar punën e paligjshme të objekteve të hotelerisë dhe klubeve të natës në Shkup. Kërcënimi i dytë ishte ndaj gazetares Maja Jovanovska, të cilës i është dërguar audio mesazh nga eksplozimi i bombës. Sipas të gjitha indiceve, mesazhi i është dërguar për shkak të hulumtimit të saj për keqpërdorimet e kompanive ndërtimore në lagjen Taftalixhe të Shkupit<sup>36</sup>.**

33 Fokus grupi i realizuar me gazetarë më 29 nëntor të vitit 2019.

34 Ibid.

35 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, “Dokument për politika publike: Statusi dhe nevoja e korrespondentëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, Shkup: gusht i vitit 2019: <https://bit.ly/2WV9b9W>

36 IRL.mk, “Reagim i SHGM: Kërcënimet ndaj ekipit të LHR përpjekje serioze për t’u heshtur gazetaria hulumtuese”, publikuar më 30 dhjetor të vitit 2019. Qasur më 16 mars të vitit 2020: <https://irl.mk/reaktsia-na-znm-zakani-kon-ekipata-na-irl-seriozen-obid-da-se-zamolchi-istrzhuvachkoto-novinarstvo/>

## B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve

Liria e gazetarëve në zgjedhjen e temave mbi të cilat do të raportojnë, sipas të dhënave të marra nga intervistat e zhvilluara dhe fokus grupet, duket se është rritur këtë vit<sup>37</sup>. Megjithatë, përzgjedhja e temave për raportim në mediat rajonale dhe në ato lokale është problem akoma më i madh për gazetarët për shkak të mjedisit të vogël në të cilin funksionojnë këto media, si dhe për shkak të lidhjeve të shprehura klienteliste të pronarëve me kryetarët e komunave dhe të fuqishmit tjerë lokalë, si dhe gjendjes gjithnjë më të keqe financiare në të cilën ndodhen këto media.

Megjithatë, flitet hapur edhe për ndikimin e një numri të redaktorëve ndaj gazetarëve, në kuptimin që ky ndikim në punën e përditshme nuk është i dukshëm, respektivisht ka më shumë vetë-censurë se sa presione të drejtpërdrejta. Gazetarët pohojnë se në redaksi paraprakisht dihet se cilat tema janë të pranueshme, cilat tema redaktori do t'i vlerësojë si të shkëlqyeshme e cilat do t'i hedhë, si dhe se ekziston hapësirë e lirë për përzgjedhjen e temave, por shpesh ka shembuj të "...ndërrhyrjeve nga ana e redaksive, nga pronarët"<sup>38</sup>. Sigurisht se nuk mund të shkruhet në kontekst negativ për sponsorët që e financojnë redaksinë, sepse në atë rast "...mund të shkaktohen konflikte"<sup>39</sup>.

Përzgjedhja e temave për raportim në mediat rajonale dhe lokale është problem akoma më i madh për gazetarët për shkak të mjedisit të vogël në të cilin funksionojnë këto medime, si dhe për shkak të lidhjeve të shprehura klienteliste të pronarëve me kryetarët e komunave dhe të fuqishmit tjerë lokalë, si dhe gjendjes gjithnjë më të keqe financiare në të cilën ndodhen këto medime.

## B6 Pozita e femrave në gazetari

Vlerësim<sup>40</sup> i përgjithshëm është se pozita e gazetareve në redaksi dallon shumë nga pozita e gazetarëve. Nuk ka të dhëna se sa gazetarë dhe gazetare kanë nënshkruar kontrata pune, por konsiderohet se punëdhënësit, në përgjithësi, kur është fjala për gazetare të punësuar në kohë të pacaktuar, i respektojnë të drejtat themelore që u janë përshkruar me ligj, siç janë: pagesa e rrogës, pushimi i lindjes dhe pushimi me pagesë<sup>41</sup>. Megjithatë, ka medime në të cilat edhe gazetareve nuk u paguhet puna gjatë ditëve të festave, puna gjatë fundjavës dhe puna jashtë orarit.

Lidhur me lartësinë e pagave, nuk ka të dhëna të reja zyrtare, por nga hulumtimet e zhvilluara paraprake mund të konkludohet se pagat e gazetarëve, përgjithësisht, janë të ulëta dhe se nuk ka dallim nëse bëhet fjalë për gazetar apo gazetare. Në korrik dhe gusht të vitit 2017 Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik ka realizuar anketë, sipas të cilës thuhet se 45% e gazetarëve të RMV-së kanë marrë pagë më të ulët se sa paga mesatare shtetërore, që ka qenë 22.808 denarë, kurse 85% pagë më të vogël se 500 euro në muaj<sup>42</sup>. Megjithatë, anketa e njëjtë ka zbuluar një dallim të madh ndërmjet pagave të redaktorëve dhe gazetarëve, sidomos në televizione. Paga e gazetareve ka qenë prej 19.000 deri 24.000 denarë, derisa e redaktorëve ka qenë prej 40.000 deri 50.000 denarë, me përjashtim të kryeredaktorëve – të hyrat e të cilëve kanë arritur madje deri në 120.000 denarë<sup>43</sup>.

Sipas rrëfimeve të vetë gazetarëve dhe gazetareve, në përgjithësi, mundësitë që gratë të zhvillohen si gazetare profesioniste dhe të përparojnë në karrierën e tyre nuk janë shumë më të vogla në krahasim me mundësitë e kolegëve të tyre gazetarë<sup>44</sup>. Të dhënat në dispozicion për sektorin audiovizuel e konfirmojnë këtë përfundim: në redaksitë e televizioneve

37 *Ishte e rëndësishme deklarata e njërit nga pjesëmarrësit në grupet e fokusit: "Mund të them se e toleroj pagën e ulët, pikërisht për lirinë që e kam në përzgjedhjen e temave, të shkruaj për gjithçka që më intereson. Kam liri të plotë, pa censurë. Kjo më ndihmon shumë që të ndërtohem si gazetare". Grupi i fokusit është realizuar me gazetarë më 29 nëntor të vitit 2019.*

38 *Deklaratë e një gazetari nga një medium i nivelit lokal. Intervistën e ka zhvilluar Dragan Sekulovski, më 26 nëntor të vitit 2019.*

39 *Ibid, faqe 8.*

40 *Sonja Trajkovski Dimitrova, "Pozita strukturore e gazetareve femra në medimet në Maqedoni", (Shkup: Instituti Maqedonas i Mediave, publikuar më dhjetor të vitit 2018), faqe 8. Qasur më 9 mars të vitit 2020: [https://www.mim.org.mk/attachments/article/1136/Strukturana%20polozba%20na%20zenitenovinar%20vo%20mediumite\\_fin.pdf](https://www.mim.org.mk/attachments/article/1136/Strukturana%20polozba%20na%20zenitenovinar%20vo%20mediumite_fin.pdf)*

41 *Ibid, faqe 8.*

42 *Tamara Čausids, "Paga në media e ngatërruar nën mesataren", SPGPM, publikuar më 21 gusht të vitit 2017. Qasur më 9 mars të vitit 2020: [www.ssnm.org.mk/komentari/natata-vo-mediumite-zaglavna-pod-np](http://www.ssnm.org.mk/komentari/natata-vo-mediumite-zaglavna-pod-np)*

43 *Ibid.*

44 *Sonja Trajkovska Dimitrova, "Pozita strukturore e femrave gazetare në media në Maqedoni", (Shkup: Instituti Maqedonas i Mediave, publikuar më dhjetor të vitit 2018), faqe 6. Qasur më 9 mars të vitit 2020: [https://mim.org.mk/mk/attachments/%20article/1136/Strukturana%20polozba%20na%20zenitenovinar%20vo%20mediumite\\_fin.pdf](https://mim.org.mk/mk/attachments/%20article/1136/Strukturana%20polozba%20na%20zenitenovinar%20vo%20mediumite_fin.pdf)*

gratë janë edhe më të shumta se sa kolegët e tyre gazetarë. Kështu që, në fund të vitit 2018, në medi- at radiodifuzive ka pasur gjithsej 540 gazetarë dhe 370 gazetarë<sup>45</sup>, kurse numri i redaktorëve dhe reda- ktoreve ka qenë pothuajse i barabartë - 105 femra dhe 108 meshkuj në pozita të redaktoreve/redak- torëve. Por, kur bëhet fjalë për pozicionet drejtuese në media, dominimi mbetet te meshkujt. Sipas të një- jtës analizë, në dhjetor të vitit 2018, meshkujt ishin dy herë më shumë (74) sesa femrat (32)<sup>46</sup>.

Në vitin 2019 u regjistruan gjithsej 24 sulme fizike dhe kërcënime ndaj gazetarëve, prej të cilave gjysma e rasteve ishin sulme ndaj gazetarëve. Nuk mund të thuhet se gazetaret në këto raste kanë qenë objekt i sulmit vetëm pse kanë qenë femra e as që në sulme ka pasur ofendime të drejtpërdrejta dhe komente që ndërlidhen me përkatësinë e tyre gjinore. Megjithatë, në disa hulumtime të zhvilluara më parë gazetaret kanë theksuar se shpesh ballafaqohen me ofendime personale dhe seksizëm në punë<sup>47</sup>.

---

45 Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. "Struktura e të punësuarve në industrinë mediatike audio dhe audiovizuale në vitin 2018", publikuar më shtator të vitit 2019. Qasur më 9 mars të vitit 2020: <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2019/09/Структура-на-работните-во-аудио-и-аудиовизуелна-медиумска-индустрија-во-2018-година.pdf>

46 Ibid.

47 Si plotësim i këtij konstatimi dëshmojnë sulmet ndaj dy gazetarëve (Meri Jordanovska dhe Iskra Koroshevskaja) që ndodhën në janar të vitit 2020, menjëherë pas përfundimit të këtij raporti.



## **C1 Statistika për sulmet ndaj gazetarëve dhe mosndëshkimi**

---

Siguria e gazetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2019 është përmirësuar në krahasim me disa vite më parë, edhe pse akoma është e pranishme politika e mosndëshkimit për dhunë ndaj gazetarëve. Numri i sulmeve fizike dhe kërcënimeve të regjistruara ndaj gazetarëve në vitin 2019, në krahasim me vitin 2018, është rritur për një rast, por ende është në mënyrë të konsiderueshme më i vogël në krahasim me vitin 2017. Gjatë tre viteve të fundit kalendarikë, në periudhën prej vitit 2017 deri në vitin 2019, SHGM-ja në Regjistrin e vet ka shënuar gjithsej 27 sulme ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik, edhe atë për vitin 2017 gjithsej 20 raste, në vitin 2018 - 3 sulme dhe për vitin 2019 gjithsej 4 sulme. Krahas katër sulmeve më serioze ndaj gazetarëve të regjistruara në vitin 2019 SHGM-ja ka vërejtur edhe 24 kërcënime dhe incidente të tjera. Gjatë 15 viteve të fundit organet formalisht nuk kanë hetuar vrasje të ndonjë gazetari apo punonjësi mediatik në vend.

## Numri i sulmeve të raportuara ndaj gazetarëve në vitin 2019

Kategoritë	Number	Përshkrimi
Kërcënime për jetë dhe lëndime të rënda fizike	4	Kërcënime verbale dhe me shkrim ndaj integritetit fizik, duke përfshirje edhe kërcënime me vdekje, drejtpërdrejt ose përmes personave të tretë, përmes komunikimit elektronik ose të drejtpërdrejtë. Kërcënimet mund të jenë implicite ose eksplicite dhe të përfshijnë kërcënime për vrasje ndaj anëtarëve të gazetarëve, kolegëve të tyre ose në zgjedhje.
Kërcënime të tjera ndaj gazetarëve	14	Kërcënime që përfshijnë mbikëqyrje ose ndjekje, thirrje telefonike shqetësuese, shqetësim arbitrar gjyqësor ose administrativ, deklarata agresive nga ana e zyrtarëve publikë ose forma të tjera të presionit që mund të kërcënojnë sigurojnë e gazetarëve në kryerjen e veprimtarisë së tyre profesionale.
Kërcënime ndaj shtëpive mediatike dhe organizatave	2	Kërcënime verbale ose me shkrim për sulme ndaj pronës ose të punësuarve në media të dërguara drejtpërdrejt ose përmes personave të tretë në formë elektronike ose përmes komunikimit të drejtpërdrejt. Ato mund të jenë implicite ose eksplicite dhe të përfshijnë referimin/aludimin ndaj një shtëpie mediatike të caktuar ose të punësuarit e saj.
Sulme ndaj gazetarëve	1	Sulmet mund të përfshijnë lëndim fizik ose psikik, kidnapim, hyrje me forcë në banesë/zyrë, konfiskim i pajisjes, paraburgim, tentim për vrasje etj.
Vrasje të gazetarëve	0	Janë përfshirë të gjitha llojet e vrasjeve.
Sulme ndaj shtëpive mediatike dhe organizatave	3	Sulme ndaj pronës së shtëpive mediatike dhe organizatave, punonjësit e tyre, konfiskim i pajisjes, deklarata agresive nga zyrtarët etj.

Rasti i parë është sulmi fizik ndaj gazetares Mirjana Jovanović nga TV Kanal 5, nga një pjesëtar i Agjencisë Private për Sigurim "Nikob". Për këtë incident, vetë gazetarja ka deklaruar: "Sinqerisht, gati një vit pas raportimit për festën e Ujërave të Bekuar nuk mund ta kuptoj se përse kishte aq nxitje për agresion nga njerëzit që ishin të angazhuar për ta siguruar njeriun që e kapi kryqin e shenjtë dhe priftërinjtë që e bekuan atë ditë. Është e pakuptueshme një shtyrje e tillë nga ana e personave të Agjencisë së Sigurimit "Nikob", thua se ne gazetarët do të merrnim kryqin. Dhe, pak para këtij incidenti u prezantova para atyre se jam gazetare".

Sulmi i dytë është kërcënim verbal për jetën ndaj redaktorit Aco Kabranov nga një biznesmen lokal. Kërcënimi ka ndodhur me telefon, gjë për të cilën ka raportuar edhe media kur redaktori në fjalë është i angazhuar.

Rasti i tretë është kërcënim verbal dhe sulm fizik ndaj ekipit të TV 21 në komunën e Haraçinës, me elemente të privimit të paligjshëm të lirisë, për të cilën ngjarje u publikuan edhe audio materiale dhe incizime nga media në fjalë. Rasti nuk është denoncuar zyrtarisht në MPB, për çka Ministria e Punëve të Brendshme thotë se nuk është në gjendje të fillojë procedurë. SHGM-ja vazhdimisht ka theksuar publikisht se për shkak të natyrës së veprës, duhet që vetë Prokuroria të ndërmarrë veprime sipas detyrës zyrtare.

Sulmi i katërt i regjistruar është ndaj gazetares Maja Jovanovska nga Laboratori Hulumtues i Reporterëve, kur në telefonin e saj është dërguar mesazh audio nga eksplozimi i bombës. Ajo incidentin e denoncoi në SHGM, dhe për të cilën ngjarje kishte reagime publike,

por i njëjti nuk u procedua nga MPB-ja sepse, sipas tyre, gazetarja nuk e ka denoncuar rastin në stacion policor.

Krahas këtyre katër sulmeve, u regjistruan edhe shumë ngjarje publike të pashembullta të funksionarëve qeveritarë<sup>48</sup>, përfaqësuesve të Kuvendit<sup>49</sup>, nga Gjykata Kushtetuese<sup>50</sup>, por edhe të përfaqësuesve së partive

48 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "Ministrat të përmbahen nga deklaratat që perceptohen si kërcënime ose etiketime", publikuar më 30 janar të vitit 2019. Qasur më 21 dhjetor të vitit 2019: <https://znm.org.mk/%D0%BC%D0%B8%D0%BD%D0%B8%D1%81%D1%82%D1%80%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B4%D0%B0-%D1%81%D0%B5-%D0%B2%D0%BE%D0%B7%D0%B4%D1%80%D0%B6%D0%B0%D1%82-%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D0%B7%D1%98%D0%B0%D0%B2%D0%B8-%D0%BA%D0%BE/?lang=SQ>

49 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "Dënohet përhapja e dezinformimeve nga ana e deputetit Stevananhija për gazetarët Jovanoski dhe Hristov", publikuar më 18 korrik të vitit 2019, Qasur më 21 dhjetor të vitit 2019: <https://znm.org.mk/%D0%BE%D1%81%D1%83%D0%B4%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D1%88%D0%B8%D1%80%D0%B5%D1%9A%D0%B5%D1%82%D0%BE-%D0%B4%D0%B5%D0%B7%D0%B8%D0%BD%D1%84%D0%BE%D1%80%D0%BC%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0%B8-%D0%BD%D0%B0-%D0%BF%D1%80/?lang=SQ>

50 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "SHGM: Dënojmë trajtimin e gazetarëve në ndërtesën e Gjykatës Kushtetuese", publikuar më 16 dhjetor të vitit 2019. Qasur më 21 dhjetor të vitit 2019: <https://znm.org.mk/%D0%B7%D0%B0%D0%BE%D1%81%D1%83%D0%B4%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D0%BE%D0%B4%D0%BD%D0%BE%D1%81%D0%BE%D1%82-%D1%81%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%BC%D0%B0-%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D1%80%D0%B8%D1%82/?lang=SQ>



politike<sup>51</sup>, në të cilat ata sulmojnë ose ofendojnë gazetarë. SHGM-ja shumë herë ka reaguar mbi këto ngjarje, duke theksuar se me këtë cenohet i gjithë integriteti i profesionit të gazetarisë, sidomos kur ato vijnë nga Kryetari i Qeverisë<sup>52</sup>, ministrat, lideri i partisë më të madhe opozitare<sup>53</sup> ose nga bartës të tjerë të funksioneve të larta publike.

Në vitin 2019, po ashtu, u vërejt një praktikë negative e punonjësve të Qeverisë (në disa raste, shpesh gjatë orarit të punës), duke postuar përmbajtje në profilet e tyre në media sociale, në të cilat i sulmojnë ose fyjnë gazetarët. Postimet shpesh ishin si përgjigje e artikujve kritikë të gazetarëve ose informacioneve të pretenduara “jo të plota” për punën e Qeverisë. Këto postime mund të interpretohen si presion i autoriteteve ndaj gazetarisë kritike, sepse ato vijnë nga individë që janë nëpunës shtetërorë<sup>54</sup>.

Në vitin 2019 numri i fushatave negative mediatike ndaj organizatave mediatike kritike është zvogëluar, dhe të njëjtat ende shfrytëzohen si instrument për presion. Për shembull, në rrjetin social Twitter nga profilet anonimë, por politik aktiv, udhëhiqej fushatë kundër SHGM-së, duke publikuar emra dhe fotografi të të gjithë anëtarëve të organeve drejtuese të SHGM-së, të shoqëruara me numër të madh të ofendimeve dhe nënçmimeve. Përveç kësaj, një numër i mediave raportonin në mënyrë jo etike, të anshme dhe joprofesionale në rastet kur SHGM-ja i kritikonte veprimet e funksionarëve qeveritarë apo të përfaqësuesve të opozitës ndaj gazetarëve.

Përqindja e rasteve të zbardhura plotësisht për sulmet ndaj gazetarëve është e vogël dhe kjo është shumë shqetësuese për sa i përket mosndëshkimit të autorëve. Zgjidhje gjyqësore presin ndërmjet 5 dhe 10% të rasteve të regjistruara të të drejtave të gazetarëve që janë në Regjistrin e SHGM-së për sulmet për pesë vitet e fundit. Nga ana tjetër, nga katër sulmet serioze në vitin 2019, sulmi më serioz ishte kidnapimi i ekipit të TV21 në prill. Prokuroria Publike nuk filloi hetim për këtë rast, me arsyetim se gazetarët nuk e firmosën deklaratën në polici. SHGM-ja disa herë ka thirrur publikisht Prokurorinë që të fillojë hetimin për çështjen sipas detyrës zyrtare por, megjithatë, ata kanë thënë se nuk kanë gjetur elemente të veprës penale. Ministria e Punëve të Brendshme, ndërkohë, këtë sulm e ka kualifikuar si ankesë dhe nuk kanë vazhduar me procedim të mëtejshëm sepse gazetarët nuk e kanë nënshkruar procesverbalin.

Përveç kësaj, në takimet me MPB<sup>55</sup> vazhdimisht është insistuar në hetime më të shpejta dhe efikase për sulmet ndaj gazetarëve, por edhe për përmirësimin e kushteve për punë të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë kur raportojnë nga ambientet e këtij institucioni. Me sugjerim të SHGM-së, si dhe pas theksimit të kësaj mangësie në raportet e institucioneve ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Brendshme filloi të mbajë evidencë për sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatikë. SHGM-ja me Avokatin e Popullit në maj të vitit 2019 nënshkroi Memorandum Bashkëpunimi përmes të cilit të dyja institucionet obligohen të punojnë në mënyrë aktive në të ardhmen për tema që ndërlidhen me sigurinë e gazetarëve.

Në kontekstin e dënimit të dhunës ndaj gazetarëve dhe thirrjeve për zbardhjen sa më të shpejtë të atyre sulmeve, Komisioni Evropian në raportin e tij vjetor për progresin e Maqedonisë në vitin 2019 përsëri e trajton çështjen e sigurisë së gazetarëve dhe rekomandon: “vendi duhet të vazhdojë t'i kushtojë vëmendje hetimeve të shpejta dhe efektive të të gjitha rasteve të dhunës fizike dhe verbale ndaj gazetarëve nga ana e policisë dhe organeve gjyqësore”.

51 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, “Dënojmë fyerjet e zëdhënësit Dimçe Arsovski kundër gazetarit Furkan Saliu”, publikuar më 20 dhjetor 2019. Qasur më 21 dhjetor të vitit 2019: <https://znm.org.mk/%D0%BE%D1%81%D1%83%D0%B4%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D0%BD%D0%B0%D0%B2%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%BD%D0%B0-%D0%BF%D0%BE%D1%80%D1%82%D0%BF%D0%B0%D1%80%D0%BE%D0%B0%D0%BE%D1%82-%D0%B4%D0%B8%D0%BC/?lang=SQ>

52 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, “SHGM dënon deklaratën e Zaevit dhe kërkon falje publike”, publikuar më 13 gusht të vitit 2019. Qasur më 21 dhjetor të vitit 2019: <https://znm.org.mk/%D0%B7%D0%BD%D0%BC-%D1%98%D0%B0-%D0%BF%D1%81%D1%83%D0%B4%D1%83%D0%B2%D0%B0-%D0%B8%D0%B7%D1%98%D0%B0%D0%B2%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%B7%D0%B0%D0%B5%D0%B2-%D0%B8-%D0%B1%D0%B0%D1%80%D0%B0-%D1%98/?lang=SQ>

53 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, “SHGM: Dënojmë Mickoskin për publikimin në të cilin etiketoi gazetarët e ITV”, publikuar më 15 gusht të vitit 2019. Qasur më 21 dhjetor të vitit 2019: <https://znm.org.mk/%D0%B7%D0%BD%D0%BC-%D0%BE%D1%81%D1%83%D0%B4%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%BC%D0%B8%D1%86-%D0%BA%D0%BE%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D0%B7%D0%B0-%D0%BE%D0%B1%D1%98%D0%B0%D0%B2%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D1%81%D0%BE-%D0%BA%D0%BE/?lang=SQ>

54 Sërgjan Stojančov, “Qeveria, lajmet e rreme dhe përgjeshtrimet e rreme”, Radio Evropa e Lirë, 6 gusht të vitit 2019. Qasur më 17 tetor të vitit 2019: <https://www.slobodnaevropa.mk/a/vladata-podnana-prvata-krivina-vo-borbata-protiv-lajnite-vesti/30094947.html>

55 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, “Seksioni i kameramanëve pranë SHGM-së në takim me përfaqësues të MPB-së”, publikuar më 8 gusht të vitit 2019. Qasur më 19 dhjetor të vitit 2019: <https://znm.org.mk/%D1%81%D0%B5%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D0%BD%D0%B8%D0%BC%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B8%D0%B8-%D0%BF%D1%80%D0%B8-%D0%B7%D0%B0%D0%BC-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D1%80%D0%B5%D0%B4/?lang=SQ>

## C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe e aktorëve politikë ndaj sigurisë së gazetarëve

Kur bëhet fjalë për (mos)veprimin e institucioneve në lidhje me sulmet ndaj gazetarëve, niveli i mosndëshkimit është ende shumë i lartë. Në rrethin e formuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria Publike dhe gjykatat pothuajse gjithmonë “zhduket” së paku njëra nga këto tre institucione. Në dy vitet e fundit, për fat të keq, kjo është vërejtur gjithnjë e më shumë nga Prokuroria Publike, e cila në disa raste sulmeve ndaj gazetarëve nuk ka ndër marrë asnjë veprim fare, kurse në rastet kur ka nisur hetimet, të njëjtat i udhëheq shumë ngadalë dhe në mënyrë joefikase.

Në vitin 2019 përsëri vërehet një trend i dënimit publik për sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatikë për disa raste për të cilat SHGM-ja ka reaguar publikisht. Shembull për këtë janë incidentet me ekipin e TV21 në Haraçinë, kur reagoi publikisht kryetarja e Komunës, Milikie Halimi<sup>56</sup> e cila e dënoi incidentin dhe kërkoi hetim të shpejtë dhe efikas nga MPB-ja. Për këtë incident, gjithashtu, reagoi edhe përfaqësuesi i OSBE-së për lirinë e mediave Harlem Dezir<sup>57</sup>. Ai ka dënuar frikësimin dhe kërcënimet ndaj gazetarëve, kurse në mesin e atyre që e dënuan publikisht këtë rast ishte edhe Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Përfaqësimin e Lirisë së Mediave dhe Mbrojtjen e Gazetarëve.

Ministria e Punëve të Brendshme udhëheq Regjistër intern për sulmet ndaj gazetarëve, por ato të dhëna nuk i prezanton publikisht. Për nevojat e kësaj analize, më 15 tetor të vitit 2019 Ministria e Punëve të Brendshme dorëzoi përshkrim detal të të gjitha sulmeve ndaj gazetarëve, të cilat kanë qenë të denoncuar në MPB. Regjistër<sup>58</sup> të azhurnuar rregullisht për sulme dhe kërcënime ndaj gazetarëve mban vetëm Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. Regjistri është në dispozicion publik në uebfaqen e Shoqatës.

Deri më tani ushtria dhe policia nuk kanë miratuar dokumente të brendshme, për t'i mësuar pjesëtarët e tyre se si të sillen me gazetarët. Këto institucione nuk kanë as rregullore ose dokumente të tjera që ndalojnë kërcënimet, frikësimet ose sulmet ndaj gazetarëve. Por, në vitin 2020 SHGM-ja me Qendrën Ndërkombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm filloi projekt në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme. Njëri nga rezultatet e këtij aktiviteti, krahas shumë trajnimeve me gazetarë, është edhe krijimi i protokolleve dhe pranimit i tyre nga ana e institucioneve dhe medimeve në drejtim të informimit etik për çështje që lidhen me temën për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Me qëllim të përmirësimit të sigurisë së gazetarëve dhe vënies fund mosndëshkimit për sulmet ndaj gazetarëve, SHGM-ja bashkëpunon thujse me të gjitha institucionet relevante në shtet. Këtë vit janë zhvilluar gjashtë punëtori, në secilin qytet të madh të vendit, në të cilat kanë marrë pjesë gazetarë, punonjës mediatik dhe pjesëtarë të policisë. Po ashtu, në temën ‘Siguria e gazetarëve dhe bashkëpunim më i mirë me policinë’ janë organizuar shumë punëtori në të cilat kanë marrë pjesë përfaqësues të SHGM-së, e të cilat ishin organizuar nga Sektori për kontroll të brendshëm pranë MPB-së. Në drejtim të intensifikimit të bashkëpunimit, më 30 dhjetor të vitit 2019 u nënshkrua edhe Protokollin për Bashkëpunim ndërmjet SHGM-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme<sup>59</sup>. Ky dokument në njëfarë mënyre paraqet sendërtim të Kodit Etik të Policisë por, gjithashtu, jep orientime për bashkëpunim ndërmjet gazetarëve dhe policisë, që ka për qëllim sigurinë më të lartë të gazetarëve në kryerjen e detyrave profesionale.

Tashmë dy vite me radhë Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë organizon ngjarje për shënimin e 2 Nëntorit – Ditës Ndërkombëtare Kundër Mosndëshkimit të Krimeve ndaj Gazetarëve<sup>60</sup>.

Përpos aferës së madhe të përgjimit në vitin 2015, kur qindra gazetarë ishin në listën e policisë sekrete për përgjim, SHGM-ja nuk njohuri se në vitin 2019 ndonjë gazetar ka qenë i ekspozuar ndaj ndjekjes elektronike nga autoritetet. Mbetet e panjohur se në cilën fazë është

56 „Kryetarja e Komunës së Haraçinës e ka dënuar sulmin ndaj ekipit të TV21”, “Sloboden pečat”, 17 prill 2019. Qasur më 18 dhjetor të vitit 2019: <https://www.slobodenpecat.mk/gradonachalnichkata-naarachinovo-go-osudi-napadot-vrz-ekipata-na-tv21/>

57 MKD.mk, “Dezir: Sulmi ndaj ekipit të TV21 është sulm ndaj lirisë së mediave”, publikuar më 15 prill 2019. Qasur më 18 dhjetor 2019: <https://www.mkd.mk/makedonija/politika/dezir-napadot-vrz-ekipata-na-tv21-e-napad-vrz-slobodota-na-medijumite>

58 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, “Rastet e shkeljes së të drejtave të gazetarëve”, publikuar në maj të vitit 2019. Qasur më 17 dhjetor të vitit 2019: <https://znm.org.mk/%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D0%B5%D1%88%D1%82%D0%B0%D0%B8%D1%81%D0%BB%D1%83%D1%87%D0%B0%D0%B8%D0%BD%D0%B0-%D0%B F%D0%BE%D0%B2%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%B0-%D0%B D%D0%BE%D0%B2%D1%80%D0%B0-%D0%B2%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%B5%D0%B4%D0%B0-%D0%B D%D0%BE%D0%B2%D1%80%D0%B0-%D0%B2%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B5%D0%BF%D1%80%D0%B0-%D0%B2%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%B D%D0%B0-%D0%B2%D0%B8%D0%BD-14/?lang=SQ>

59 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, “Protokoll për bashkëpunim ndërmjet SHGM-së dhe MPB-së”, publikuar në dhjetor të vitit 2019, Qasur më 3 janar të vitit 2020: <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/01/Протокол-за-соработка-на-ШГМ-и-МБП.pdf>

60 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, “SHGM: Të përshpejtohen proceset për pastrimin e sulmeve mbi gazetarët”, publikuar më 1 nëntor të vitit 2019, Qasur më 19 dhjetor të vitit 2019: <https://znm.org.mk/%D0%B7%D0%B7%D0%BC-%D0%B4%D0%B0-%D1%81%D0%B5-%D0%B7%D0%B0%D0%B1%D1%80%D0%B7%D0%B0%D0%B0%D1%82-%D1%81%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%BF%D1%80%D0%BE%D1%86%D0%B5%D1%81%D0%B8-%D0%B7%D0%B0-%D1%80%D0%B0%D1%81%D1%87/?lang=SQ>

kontesti gjyqësor lidhur me këtë çështje dhe nëse i njëjti procesuohet me qëllim që të përcaktohet shkella e të drejtave të gazetarëve që ishin përgjuar në vitin 2015.

### C3 Efikasiteti i sistemit gjyqësor në mbrojtjen e gazetarëve

Gjykata Themelore Civile dhe Penale në Shkup tashmë tre vjet me radhë nuk është në gjendje të japë informacione detale në lidhje me fazën e procesimit të lëndëve në të cilat gazetarët janë viktime. Arsyetimi i tyre është se sistemi i ri për ndarjen e lëndëve (AKMIS) bazohet në kode e jo në emra dhe në profesione të palëve. Përfundim bën vetëm Gjykata Civile e cila ka regjistër joformal të veprave për shpifje dhe fyerje. Mosndëshkimi i kryerësve mbetet i lartë dhe përfundim gjyqësor është konstatuar në më pak se 10% të rasteve të regjistruara, të cilat janë gjithsej 56 në periudhën prej prillit të vitit 2014 deri në dhjetor të vitit 2019.

Në institucione nuk ekzistojnë procedura të posaçme për trajtimin e sulmeve ndaj gazetarëve. Në sistemin gjyqësor-prokurorial në Maqedoninë e Veriut nuk ekzistojnë njësi të posaçme që punojnë në hetime për raste për ndjekje, mbrojtje dhe kompensim të gazetarëve, me qëllim që të sigurohet siguria e tyre dhe të parandalohet politika e mosndëshkimit. Procedura speciale nuk aplikohen edhe për rastet kur viktime të sulmeve janë gazetaret. Gjyqësori dhe Prokuroria asnjëherë nuk janë ankuar publikisht se lëndët për gazetarët nuk mund t'i udhëheqin në mënyrë efektive për shkak të mungesës së resurseve njerëzore dhe materiale.

Lidhur me kapacitetet e institucioneve për të zhvilluar hetime efektive, me iniciativë të SHGM-së dhe OSBE-së dhe në bashkëpunim me MPB-në, Prokuroria dhe gjykatat themelore në Shkup, në vitin 2018 dhe 2019 u organizuan një sërë trajnimesh për nëpunësit policorë, prokurorët dhe gazetarët në temën mbi lirinë e shprehjes dhe sigurisë së gazetarëve. Ambasada holandeze në Shkup, po ashtu, e ka mbështetur SHGM-në në procesin e realizimit të këtyre trajnimeve për vitin 2019. Megjithatë, sipas institucioneve, përveç ndihmës në pjesën e trajnimeve dhe aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes të punonjësve të ndërlidhura me temat e sigurisë, gazetarëve u nevojiten edhe resurse dhe pajisje shtesë dhe modernizim teknik.

Këtë vit nuk vërejmë raste të sigurimit fizik nga MPB-ja për gazetarë të caktuar, por ka një rast kur një gazetar i Projektit për raportim për krim të organizuar dhe korrupsion<sup>61</sup> katër muaj ishte i siguruar me sigurim fizik. Në

përgjithësi, gazetarët nuk dëshirojnë të kenë sigurim fizik, sepse kjo mund të ndikojë në punën e tyre të lirë dhe në sigurimin e informacioneve të reja.

Sa i përket punës së institucioneve dhe zbardhjes së sulmeve ndaj gazetarëve ekziston një moskoordinim dhe dobësi e caktuar në komunikimin ndër-institucional, dhe kjo është më e dukshme ndërmjet MPB-së dhe PTHP. Kjo ndikon që lëndët, respektivisht hetimet të zgjasin më shumë, madje edhe kur është fjala për raste të dukshme që shumë lehtë mund të dëshmoen. Për shembull, ish kryetari i SHGM-së, Naser Selmani, mori mesazh kërcënues në Facebook. Personi i cili kërcënoi madje edhe publikisht pranoi se e ka bërë të njëjtën, kurse PTHP dhe MPB edhe pas një viti e gjysmë nuk mund ta zbardhin këtë rast. Ky mosazhurnim i institucioneve shpie në situatë që sulmuesit të inkurajohen të sulmojnë gazetarë, sepse e dinë që drejtësia, me gjasë, kurrë nuk do të arrihet. Prandaj, SHGM-ja konsideron se hetimet nuk janë mjaftueshëm efektive, kurse masat për mbrojtje janë joadekuate.

Akademia për Trajnimin e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë në bashkëpunim me SHGM-në do të vazhdojë të realizojë trajnime me gazetarët dhe përfaqësuesit e Gjyqësorit në periudhën vjetore 2020/21 dhe, përveç kësaj, edhe tema që ndërlidhen me lirinë e shprehjes janë pjesë e përmbajtjeve të rregullta për trajnime të Akademisë, dedikuar për gjykatësit dhe prokurorët.

Lidhur me bashkëpunimin me institucionet, SHGM-ja ka mbajtur takime konsultative thujse me të gjitha institucionet që duhet të garantojnë sigurinë e gazetarëve, duke përfshirë edhe kryetarët e Prokurorisë Themelore Publike, Gjykatës Themelore Penale dhe Gjykatës Themelore Civile. Me qëllim që të zvogëlohet përqindja e mosndëshkimit për sulmet ndaj gazetarëve, SHGM-ja ka bashkëpunuar dhe ka zhvilluar takime me Gjykatën Penale në Shkup<sup>62</sup>, si dhe me Prokurorinë Themelore Publike<sup>63</sup>. Në këto takime është biseduar për organizimin e trajnimeve dhe punëtorive të përbashkëta për gazetarët, gjykatësit dhe prokurorët me qëllim që të përmirësohet raportimi i gazetarëve dhe veprimi i prokurorëve për rastet që ndërlidhen me lirinë e shprehjes.

62 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "Cadikovski në takim me kryetarin e Gjykatës Penale të Shkupit, Ivan Xholec", publikuar më 27 mars të vitit 2019. Qasur më 19 dhjetor të vitit 2019: <https://znm.org.mk/%D1%87%D0%B0%D0%B4%D0%B8%D0%BA%D0%BE%D0%B2%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%B1%D0%B0-%D1%81%D0%BE-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%82%D1%81%D0%B5%D0%B4%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B8%D0%BE/?lang=SQ>

63 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, "SHGM në takim me Joveskin: PPRM të ndërpret me persekutimin ndaj Kezharovskit", publikuar më 31 maj të vitit 2019. Qasur më 19 dhjetor të vitit 2019: <https://znm.org.mk/%D0%B7%D0%BD%D0%BC-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%B1%D0%B0-%D1%81%D0%BE-%D1%98%D0%BE%D0%B2%D0%B5%D1%81%D0%BA%D0%B8-%D0%BE%D1%98%D0%BE-%D0%B4%D0%B0-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%BD/?lang=SQ>

61 Organized Crime and Corruption Reporting Project

**Pasqyrë për pesë rastet më serioze të kërcënimeve ndaj gazetarëve gjatë 5 viteve të kaluara:**

Viti	2015	2016	2017	2018	2019
Rasti					
1. Ekipi gazetaresk i TV21 – pasi ekipi i TV 21 ka bërë kronikë në lidhje me ankesat e banorëve të komunës së Haraçinës lidhur me infrastrukturën e keqe, të afërmit e kryetares së Komunës, Milikije Halimi, kanë kërcënuar në mënyrë verbale ekipin televiziv se do ta thyejnë kamerën dhe kanë kërkuar që të fshihen incizimet/sequencat.					Rasti nuk ka qenë i denoncuar në polici, por Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë disa herë i ka bërë thirrje policisë dhe Prokurorisë Publike të hapin hetime. Megjithatë, Prokuroria ka vendosur të mos veprojë sipas zërave të dëgjuar.
2. Naser Selmani – gazetar dhe ish kryetar i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë ka marrë mesazh me kërcënim me vdekje nga Bejtulla Asani, vëlla i Beqir Asanit – i cili është i lidhur me partinë politike qeveritare, BDI.				Rasti është denoncuar në polici, kurse Prokuroria ka hapur hetim. Deri më tani janë ftuar të japin deklaratë Naser Selmani dhe kërcënuesi.	Rasti vijon në Prokurorinë Themelore Publike.
3. Armand Braho – militantë nga radhët e partisë Aleanca për Shqiptarët e kanë sulmuar gazetarin Armand Braho gjatë konferencës, në të cilin ai ka pasur ftesë të rregullt.				Rasti është denoncuar në polici. Gjykata i ka ndëshkuar sulmuesit me gjyba në të holla.	
4. Grup i gazetarëve – shumë gazetarë dhe punonjës mediatikë ishin sulmuar nga turma që hynë me dhunë në Parlament më 24 Prill 2017.			Rasti është denoncuar në polici. Prokuroria Publike nuk ka ndërmarrë asnjë masë.	Prokuroria i ndjekë personat që i kanë sulmuar politikanët, kurse nuk i ndjekë personat që kanë sulmuar gazetarë dhe punonjës mediatik.	Avokatët e SHGM-së përfaqësojnë 7 gazetarë dhe në emër të tyre do të parashtrajnë 4 padi, prej të cilave 3 padi janë veçmas, kurse 1 është padi grupore për 3 gazetarë.
5. Vlladimir Zhellçeski dhe Aleksandar todorov, duke raportuar nga protesta e madhe “Për Maqedoninë e Përbashkët”, të dy gazetarët janë sulmuar fizikisht nga persona të panjohur, pjesëmarrës të protestës, sepse nuk u kanë takuar mediave qeveritare. Ata kanë qenë të sulmuar disa herë, të cilët u është shkaktuar lëndime trupore, e të cilët më pas kanë qenë të shtrirë në spital për 24 orë.			Rasti është denoncuar në polici dhe Prokuroria Publike ka hapur hetim.	Gjykata ka shqiptuar dënim me burg prej 6 muajve për sulmuesit.	

Qeveria, e formuar në qershor të vitit 2017, edhe në premtimet parazgjedhore dhe pasi e mori pushtetin, premtonte në vazhdimësi përmirësimin e gjendjen me lirinë e shprehjes, në radhë të parë përmes përmirësimit të legjislacionit që e rregullon punën e mediave. Liria e shprehjes gjatë tre viteve të kaluara dukshëm është përmirësuar, para së gjithash si rezultat i vullnetit të shtuar politik për t'u liruar nga presionet dhe censura, që ishin paraprakisht të pranishme. Megjithatë, ligjet u vonuan. Deri në fund të vitit 2018 nuk u miratua në Parlament thuajse asnjëra nga ndryshimet e paralajmëruara ligjore, kurse deri në fund të vitit 2019 nuk u filluan as hapat e parë për reformimin e servisit radiodifuziv publik dhe për përforcimin e kapaciteteve dhe pavarësisë së Rregullatorit mediatik. Për reformat e bllokuara në Parlament, Qeveria vazhdimisht e sulmonte opozitën dhe anasjelltas. Nga ana tjetër, referendumi në vitin 2018, zgjedhjet presidenciale në vitin 2019, si dhe çështjet më të rëndësishme të jashtme politike për zgjidhjen e kontesteve disa dhjetëvjeçare me vendet fqinje të RMV-së, po ashtu, u përdorën si alibi për prolongimin e reformave sistematike në sferën mediatike. Kështu që, në vitin 2019, TVM dhe ASHMAA-ja mbeten me përbërje të vjetra në organet kryesore, mbase zëvendësimi i tyre ishte paralajmëruar që në vitin 2018. Për më tepër, nuk u zgjodh as përbërja e re e Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacionet me karakter publik, për të cilin shkak u bllokua aktiviteti i këtij organi. Kjo u reflektua negativisht në transparencën e institucioneve, sidomos të atyre në nivel lokal dhe kjo argumentohet me trendin negativ të dhënies së informacioneve me karakter publik nga komunat dhe të një numri të ndërmarrjeve komunale rreth asaj se sa mjete kanë investuar në media.

Në kushte të një tregu të vogël dhe të fragmentuar të mediave dhe lidhjeve të forta klienteliste midis pronarëve të mediave dhe politikanëve në pushtet, nuk mund të pritej të përmirësohej gjendja ekonomike e gazetarëve. Për më tepër, nga buxheti i shtetit derdheshin shumë mjete në mediat private në mënyra të ndryshme që, në masë të madhe, e minonte politikën e pavarur redaktuese dhe pozicionin e gazetarëve. Të drejtat e punës dhe kushtet ekonomike në të cilat punojnë gazetarët dhe punonjësit mediatik janë në nivel të ulët dhe ato nuk mund ta garantojnë pavarësinë e tyre socio-ekonomike. Pagat e gazetarëve janë jo të rregullta, përgjithësisht në lartësinë e pagës mesatare në shtet, kontributet zakonisht nuk u paguhen për tërë shumën dhe nuk u paguhen kompensim për punën jashtë orarit. Krahas kësaj, ende nuk ka kontrata marrëveshje kolektive në mediat private, ndërsa nuk ka as disponim nga pronarët e mediave dhe menaxherët që të vendosin këso lloj garancie për të punësuarit e tyre. Të drejtat e punës të gazetarëve edhe në të ardhmen do të jenë një nga problemet kryesore në sektorin mediatik, nëse nuk ndërmerren hapa seriozë për ndryshime në këtë sferë. Ndaj, edhe pse atmosfera e përgjithshme politike në të cilën punojnë gazetarët është shumë më e çliruar në krahasim me të kaluarën, gazetarët nuk inkurajohen të flasim për presionet brenda nëpër redaksi, që flet se ekziston vetë-censura dhe frika që të flitet hapur për këto probleme.

Edhe pse në vitin 2019 nuk kishte sulme agresive me dhunë fizike ndaj gazetarëve, megjithatë ndodhën katër incidente më serioze dhe raste të tjera të kërcënimeve që kishin efekt shumë negativ ndaj punës së gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Për shembull, disa raste të gjuhës agresive nga politikanët në pushtet

ose në opozitë me elementë përçmimi ndaj gazetarëve, si dhe disa kërcënime për padi për shpifje dhe ofendim kanë dëmtuar seriozisht nivelin tonë të lirisë së shprehjes të gazetarëve dhe mund të konsiderohen si instrumente të frikësimit të gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Gjithashtu, mungesa e iniciativës së Prokurorisë Themelore Publike për të ndërmarrë aktivitete me detyrë zyrtare për rastet që ka alarmuar komuniteti i gazetarëve më tepër u reflektua negativisht në çështjen e sigurisë së gazetarëve. Vetëm përpjekjet e MPB-së mund të vlerësohen pozitivisht në kryerjen e hetimeve të shpejta në shumicën e rasteve të sulmeve ndaj gazetarëve, si dhe për vendosjen e Regjistrimit intern për sulmet ndaj gazetarëve.

Në këtë drejtim, nevojiten edhe ndërhyrje në Kodin Penal, përmes të cilave do t'i jepen autorizime shtesë Prokurorisë Publike që me detyrë zyrtare të veprojnë në situata të caktuara, kur shkelet e drejta e gazetarit gjatë detyrës zyrtare. Në këtë mënyrë do të zgjidheshin një pjesë e sfidave dhe do të ishin kursyer gazetarët nga procedurat e shtrenjta gjyqësore, të cilat jo çdoherë kanë mundësi që në mënyrë vetanake t'i iniciojnë. Më tej, duhet të kryhet edhe analizë për gjendjen e përgjithshme ekonomike në të cilën ndodhen mediat dhe në këtë mënyrë të ofrohen masa lehtësuese me të cilat mund ta përmirësojnë punën, para së gjithash radiodifuzerët, përmes lehtësimeve të ndryshme tati-more. Për përmirësimin e standardeve në mënyrën në të cilën raportojnë mediat dhe gazetarët, Qeveria por edhe të gjithë aktorët e tjerë politikë, duhet ta mbështesin vetë-rregullimin në media dhe ta shfrytëzojnë atë, në vend që të ushtrojnë presion për mënyrën si raportojnë media të caktuara.

## Rekomandime

### A Ndërhyrjet ligjore dhe përmirësimi i implementimit të ligjeve:

- Implementim i plotë i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në drejtim të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të ASHMAA-së dhe Këshillit Programor të TVM-së nga Kuvendi i RMV-së.
- Analizë për ndryshimin dhe plotësimin e LShMAA, por edhe të ligjeve të tjera relevante në pjesën për përmirësimin e punës financiare të mediave private, para së gjithash, përmes mekanizmave për lehtësimin tatimor dhe përfitimeve të ngjashme/MSHIA/Qeveria e RMV-së dhe Kuvendi i RMV-së në bashkëpunim me komunitetin e gazetarëve dhe mediave.
- Ndryshime dhe plotësime të Kodit Zgjedhor, me të cilat do të thjeshtësohen rregullat për fushatë mediatike dhe do të zvogëlohej mundësia për keqpërdorim të reklamimit të paguar politik në mediat private.

### B Përmirësimi i të drejtave të punës së gazetarëve:

- Është e nevojshme që bashkësia e donatorëve të japë mbështetje më serioze për sindikatën e gazetarëve, në mënyrë që ajo të ketë një kapacitet më të madh në mënyrën në të cilën negocohen të drejtat e punëtorëve me institucionet relevante dhe pronarët e mediave.
- Nevojiten fushata shtesë, por edhe trajnime përmes të cilave gazetarët dhe mediat do të njohohen më shumë mbi të drejtat e tyre themelore të punës.
- Nevojiten ndërhyrje urgjente në Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtat e tjera të ngjashme, duke i sinkronizuar direktivat e reja të Komisionit Evropian, para së gjithash në fushën e realizimit kolektiv të të drejtave autoriale të gazetarëve dhe, në këtë kontekst, të paraparit e kontratave korrekte, përmes të cilave gazetarët, si dhe fotoreporterët dhe kameramanët do të financoheshin në mënyrë shtesë duke ritransmetuar ose riprodhuar materialet e tyre.

### C Përforcimi i sigurisë së gazetarëve:

- Ndryshimi dhe plotësimi i Kodit Penal, edhe atë në dy drejtime: 1. Ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave me të cilat definohet gjuha e urrejtjes në përputhje me praktikën e GjEDNj si dhe 2. Ndryshim dhe plotësim në pjesën e autorizimeve të PTHP për veprim me detyrë zyrtare gjatë sulmit ndaj gazetarit/punonjësit mediatik, si dhe parashikimi për dënime më të mëdha për kundërvajtësit/Ministria e Drejtësisë/Qeveria e RMV-së dhe Kuvendi i RMV-së në bashkëpunim me SHGM-në, SPGM-në, KEMM-in, IMM-in dhe aktorët tjerë relevantë mediatik dhe komunitetin e ekspertëve.
- Krijimi i regjistrave të posaçëm për rastet e padive kundër gazetarëve në kuadër të gjykatave themelore civile dhe penale, duke përfshirë edhe PTHP.
- Vazhdimi i trajnimeve dhe bashkëpunimit ndërmjet gazetarëve, avokatëve, gjykatësve dhe prokurorëve që ndërliken me rastet gjyqësore për sulme ndaj gazetarëve, por edhe në përgjithësi për nenin 10 të GjEDNj.
- Përmirësimi i bashkëpunimit me përfaqësuesit e ri të zgjedhur në Kuvendin e RMV-së për tema që ndërliken me politikën mediatike dhe lirinë e shprehjes.
- Vazhdimi i sendërtimit të bashkëpunimit institucional ndërmjet SHGM-së, shoqatave tjera të esnafëve, në drejtim të krijimit të protokolleve shtesë dhe procedurave të brendshme në institucionet që kontribuojnë në parandalimin e dhunës ndaj gazetarëve dhe sanksionimi i tyre efikas.
- Realizimi i fushatave për përmirësimin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatikë nga ana e shoqatave të esnafëve dhe komuniteti ndërkombëtar i donatorëve.
- Sigurimi i ndihmës së vazhdueshme juridike të gazetarëve dhe punonjësve mediatikë, si dhe shërbime plotësuese këshillëdhënëse nga shoqatat esnafa të gazetarëve në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar të donatorëve.







